



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 81

Tiranë – E mërkurë, 5 qershor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 66/2019 datë 30.5.2019	Për disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar... 6067
Vendim i Kuvendit nr. 67/2019 datë 30.5.2019	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 21/2018 “Për caktimin e përbërjes së nënkomisionit të përhershëm parlamentar ‘Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas’”..... 6067
Vendim i Kuvendit nr. 68/2019 datë 30.5.2019	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 99/2017 “Për ngritjen e nënkomisionit ‘Për qeverisjen vendore’, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, të ndryshuar..... 6067
Vendim i Kuvendit nr. 69/2019 datë 30.5.2019	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 98/2017 “Për ngritjen e nënkomisionit parlamentar ‘Për diasporën dhe migracionin’, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme”..... 6068
Rezolutë e Kuvendit datë 30.5.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2018..... 6068
Rezolutë e Kuvendit datë 30.5.2019	Për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Integritetit Evropian përgjatë vitit 2018..... 6070
Rezolutë e Kuvendit datë 30.5.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2018..... 6071
Rezolutë e Kuvendit datë 30.5.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2018..... 6072
Dekret i Presidentit nr. 11193, datë 29.5.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6074

Udhëzim i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 394, datë 9.5.2019	Për organizimin dhe funksionimin e komisionit multidisiplinar, si dhe procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimit të përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare.....	6074
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 7815, datë 29.5.2019	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje me Gjermaninë.....	6119
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4743/2, datë 30.5.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksion i rrugës Plastmas–Karbunarë”, Lushnjë.....	6119
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 730, datë 30.5.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëpartiake të Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	6120
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 73, datë 10.5.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shpesh të FRC-së në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.....	6122
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78, datë 30.5.2019	Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit.....	6123
Urdhër i drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 314, datë 28.5.2019	Për autorizimin e nënshkrimit të kërkesave social-juridike të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.....	6127

**VENDIM
Nr. 66/2019****PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 90/2017 “PËR
CAKTIMIN E ANËTARËSISË
SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Deputetët Artur Roshi dhe Krenar Rryçi caktohen anëtarë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

2. Deputetët Edmond Stojku dhe Ervis Meço caktohen anëtar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

3. Deputeti Selami Jenishehri caktohet anëtar në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 30.5.2019.

**VENDIM
Nr. 67/2019****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 21/2018 “PËR CAKTIMIN
E PËRBËRJES SË NËNKOMISIONIT TË
PËRHERSHËM PARLAMENTAR ‘PËR
BARAZINË GJINORE DHE
PARANDALIMIN E DHUNËS
NDAJ GRUAS”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, 22 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Pavarur,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Në pikën I, të vendimit të Kuvendit nr. 21/2018 “Për caktimin e përbërjes së nënkomisionit parlamentar ‘Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas’”, bëhet ky ndryshim:

1. Deputetja Amra Barova caktohet anëtare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 30.5.2019.

**VENDIM
Nr. 68/2019****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 99/2017 “PËR NGRITJEN
E NËNKOMISIONIT ‘PËR QEVERISJEN
VENDORE’, NË PËRBËRJE TË
KOMISIONIT TË PËRHERSHËM
PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET
LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE TË DREJTAT E NJERIUT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 99/2017 ‘Për ngritjen e nënkomisionit ‘Për qeverisjen vendore’, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut’, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

1. Deputetja Edlira Hyseni caktohet anëtare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 30.5.2019.

VENDIM
Nr. 69/2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 98/2017 ‘PËR
NGRITJEN E NËNKOMISIONIT
PARLAMENTAR ‘PËR DIASPORËN
DHE MIGRACIONIN’, NË PËRBËRJE TË
KOMISIONIT TË PËRHERSHËM
PARLAMENTAR PËR POLITIKËN
E JASHTME’**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, 22 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Pavarur,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën III, të vendimit të Kuvendit nr. 98/2017 ‘Për ngritjen e nënkomisionit ‘Për diasporën dhe migracionin’, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme’, bëhet ky ndryshim:

1. Deputetja Ediola Braha caktohet anëtare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 30.5.2019.

Faqe | 6068

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE PËR VITIN 2018**

Kuvendi i Shqipërisë, duke konsideruar:

- objektivat kryesorë të AMF-së në lidhje me nxitjen dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar dhe mbikëqyrjen e ligjshmërisë së veprimtarive të subjekteve të mbikëqyrura;

- veprimtarinë në funksion të rritjes së besimit të pjesëmarrësit e tregut financiar, mbrojtjen dhe informimin e konsumatorit në respektim të parimeve të transparencës;

- misionin e Autoritetit në lidhje me krijimin e një tregu bashkëkohor dhe efektiv që ofron shërbime cilësore dhe promovon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar jobankar në vend.

Mori në shqyrtim veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe vlerëson objektivat e AMF-së në drejtim të:

- hartimit të një plani konkret veprimi dhe punës me përkushtim drejt arritjes së misionit dhe synimeve strategjike, si një autoritet mbikëqyrës për tregjet financiare jobankare.

- sigurimit të realizimit të strategjisë dhe misionit në përputhje me standardet më të larta profesionale dhe me kosto racionale.

- zbatimit të standardeve më të larta etike në komunikimin dhe bashkëpunimin me grupet e interesit në procesin e mbikëqyrjes për tregjet financiare jobankare.

- publikimin sistematik të informacioneve në lidhje me tregun, si dhe shërbimet për tregjet financiare jobankare të ofruara në Republikën e Shqipërisë.

- hartimin e një plani konkret dhe të posaçëm veprimi lidhur me mirëfunksionimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe problematikën e mbartur të Fondit të Kompensimit, si për sa i përket vlerës së miraturar të Fondit të Kompensimit, ashtu dhe ecurisë së pagesave të kryera nga shoqëritë e sigurimit.

Kuvendi i Shqipërisë, duke vlerësuar maksimalisht punën e bërë gjatë vitit 2018, kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për vitin 2019, të angazhohet në këto drejtime:



- të vijojë kontrolli i përmbylljes së pagesave të prapambetura të Fondit të Kompensimit, dhe monitorimi i zbatimit të vendimeve të Bordit, me qëllim frenimin në të ardhmen të fenomenit të akumulimit të borxheve dhe moskryerjen e pagesave brenda kufijve kohorë të ngjarjes së ndodhur, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së Byrosë Shqiptare të Sigurimeve;

- të përdoren vlerësimet e rrezikut, të nxjerra nga inspektimet e bëra në të kaluarën, si bazë krahasimi midis shoqërive pjesëmarrëse në tregun e sigurimeve;

- çështjet e identifikuara si me rrezik më të lartë duhet të shërbejnë si një orientim për t'u përqendruar në inspektimet e ardhshme;

- të analizohet niveli i rrezikut që paraqesin siguruesit dhe elemente të tjera si madhësia e tyre dhe, në përputhje edhe me manualin e mbikëqyrjes, të vendosen prioritetet për alokimin e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe për inspektimet e mëtejshme;

- të bëhet ndjekja e rekomandimeve të lëna pas inspektimeve dhe sigurimi i korigjimit të tyre në një periudhë të shkurtër kohe, në përmbushje të dispozitave ligjore në fuqi, me qëllim mbrojtjen sa më të mirë të konsumatorit;

- tregjet që mbikëqyren nga AMF-ja duhet të fokusohen më shumë në drejtim të rritjes së besimit të konsumatorit dhe përmirësimit të shërbimit në tërësi dhe në funksion të kësaj është e nevojshme hartimi i një strategjie kombëtare për edukimin financiar të popullatës;

- të kryhen inspektimet në vend, pranë të gjitha subjekteve tregtare që ushtrojnë veprimtari si depozitarë të fondeve të pensionit dhe fondeve të investimit, me qëllim edhe verifikimin e procedurave të ndjekura për informimin e mjaftueshëm të depozitarëve në lidhje me kontratën dhe marrëdhënien juridike në të cilën ata po investojnë;

- në kuadër të rritjes dhe forcimit të njohurive mbi tregjet nën mbikëqyrje të AMF-së, të standardizohen procedura të qarta dhe transparente monitorimi për shoqëritë që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrje për sa i përket sjelljes së tyre ndaj konsumatorit dhe organizmi i aktiviteteve me target moshat e reja dhe studentët;

- të punohet për thithjen dhe punësimin e specialistëve me eksperiencë në fushën

financiare, si dhe rritjen e kapaciteteve të stafit ekzistues. Veprimtaritë jashtë vendit të kenë në fokus përmirësimin e aftësive për menaxhimin e skenarëve të krizave të tregjeve nën mbikëqyrje dhe marrëveshjet dypalëshe të synojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe trajnimet në institucionet homologe;

- të fillojë puna për krijimin e një sistemi të ri raportimi për tregun e kapitaleve dhe pensioneve, i cili të bëjë të mundur evidentimin *online* të ankesave të brendshme dhe gjurmimin e tyre për ofrim sa më cilësor të shërbimit dhe ky mekanizëm të synohet të shtohet edhe në sistemin aktual të tregut të sigurimeve sa i takon policave të sigurimit;

- të fillojë puna për hartimin e një dokumenti fillestar, i cili të shërbejë si orientim dhe prezantim, për nisjen e hartimit të nismave ligjore, në lidhje me zgjerimin e skemës së pensioneve private dhe rregullimin ligjor të mënyrës së organizimit të kolonës së dytë të pensioneve private. Materiali të paraqesë, pa u limituar, analizën e plotë të risqeve dhe anëve pozitive për sa u takon kapaciteteve financiare që AMF-ja beson se janë ende të lira e që parashikohet se do angazhohen në skemat e pensioneve private;

- të evidentohen problematikat e deritanishme dhe të analizohet perspektiva pesëvjeçare e tregut të titujve, duke përfshirë bërjen e projeksioneve mbi këtë treg dhe analizën e plotë të risqeve dhe anëve pozitive për sa u takon kapaciteteve financiare që AMF-ja beson se mund të parashikohen se do angazhohen në tregun e titujve;

- të vazhdojë përmirësimin e sistemit të shitjes *online* dhe të shikojë mundësinë, në bashkëpunim me tregun, për një sistem të ri të integruar dhe në kohë reale për të gjitha produktet e sigurimit, duke përfshirë edhe produktet vullnetare, si dhe raportimin e dëmeve dhe çdo raportim tjetër që i shërben mirëfunksionimit të tregut, duke marrë praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Miraturar në datën 30.5.2019.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

**REZOLUTË****PËR VEPRIMTARINË E KËSHILLIT
KOMBËTAR TË INTEGRIMIT
EVROPIAN PËRGJATË VITIT 2018**

- Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe duke marrë në konsideratë rolin e Kuvendit, si organi më i lartë ligjvënës dhe kontrollues;

- Duke riafirmuar se objektivi strategjik i Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në Bashkimin Evropian, dhe me mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që Bashkimi Evropian dhe shtetet e tij anëtare i kanë dhënë Shqipërisë në përmbushje të reformave integruese;

- Duke riafirmuar mbështetjen e palëkundur për të respektuar vlerat mbi të cilat ndërtohet Bashkimi Evropian dhe vendosmërinë për zhvillimin e një shoqërie demokratike, bazuar në sundimin e ligjit, respektin për të drejtat e njeriut dhe parimet e ekonomisë së tregut;

- Duke marrë në konsideratë faktin që gjithëpërfshirja dhe transparenca janë thelbësore për progresin e qëndrueshëm të Shqipërisë në procesin e integrimit evropian;

- Duke marrë në konsideratë reformat e ndërmarra në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe përparimin e bërë nga Shqipëria në plotësimin e rekomandimeve kyçe të Komisionit Evropian dhe zbatimin e qëndrueshëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

- Duke theksuar vendosmërinë tonë për krijimin dhe konsolidimin e një administrate publike eficiente, të aftë për të përballuar detyrimet e anëtarësimit, dhe forcimin e kapaciteteve të të gjitha grupeve të interesit;

- Duke theksuar rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të përfshirjes dhe rolit të shoqërisë civile në procesin integrues të vendit, me qëllim forcimin e dialogut gjithëpërfshirës dhe rritjen e transparencës në procesin e integrimit evropian;

- Duke theksuar synimin për forcimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të organeve, nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron

përgjegjësinë e tij në procesin e integrimit evropian;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

1. Vlerësoi Raportin e Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian për vitin 2018 dhe rolin e tij në mbikëqyrje të progresit dhe përgatitjes për anëtarësim të arritur nga Shqipëria gjatë vitit 2018.

2. Përgëzon rolin e tij në drejtim të zhvillimit të dialogut gjithëpërfshirës mbi çështjet e integrimit evropian dhe inkurajon forcimin e mëtejshëm të rolit të tij në mbikëqyrje të reformave integruese të vendit dhe garantimit të gjithëpërfshirjes.

3. Vlerëson kontributin e vazhdueshëm të Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian për fuqizimin e kapaciteteve administrative në çështjet e integrimit evropian.

4. Thekson se angazhimi i qëndrueshëm për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe konkluzioneve të Këshillit Evropian përbën përparësinë kryesore të punës së Kuvendit të Shqipërisë dhe organeve, nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e integrimit evropian, si Komisioni i Integrimit Evropian dhe Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian.

5. Shpreh vullnet të plotë për të ecur në rrugën e reformave në frymën e mirëkuptimit ndërpartiak dhe në bashkëpunim të plotë me shoqërinë civile dhe reflektimin e tij në veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian përgjatë vitit 2019.

6. I kërkon Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian të forcojë bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe me organet shtetërore, anëtarë të përhershëm apo me statusin e të ftuarit në Këshill, me qëllim përmirësimin cilësor të monitorimit të procesit të integrimit evropian.

7. I kërkon Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian të forcojë më tej rolin e tij si një forum kombëtar gjithëpërfshirës, cili nxit bashkëpunimin ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile dhe garanton transparencën për vendimmarrjen në çështjet e integrimit.

Miraturar në datën 30.5.2019.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

**REZOLUTË****PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AVOKATIT TË POPULLIT
PËR VITIN 2018****Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,**

- duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit si institucion kushtetues i rëndësishëm në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

- duke vlerësuar rolin e veçantë të Avokatit të Popullit në nxitjen e standardeve më të larta në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, si dhe rolin proaktiv në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në veçanti, të grupeve më vulnerabël në shoqëri;

- duke vlerësuar rolin e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit në promovimin e këtij institucioni dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në gjithë hapësirën gjeografike ku këto zyra operojnë;

Vlerëson veprimtarinë e Avokatit të Popullit, për vitin 2018, lidhur me:

- Rritjen e vëmendjes për respektimin e të drejtave të grupeve të veçanta të marginalizuara si: fëmijët, të huajt etj.

- Dhënien e kontributit në mënyrë proaktive për përmirësimin e legjislacionit vendas, në përmbushje edhe të rekomandimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit.

- Dhënien e 171 rekomandimeve, pavarësisht mosplotësimit me kapacitet të plotë, me komisionerë për vitin 2018.

- Rritjen e numrit të çështjeve të inicluara kryesisht.

- Forcimin e bashkëpunimit me institucionet partnere ndërkombëtare.

- Rritjen e vëmendjes së Mekanizmit për Parandalimin e Torturës në respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, në komisaritet e policisë, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në Qendrën e Trajtimit të të Huajve të Parregullt në Shqipëri dhe Qendrën e Azilkërkuesve, pikat e ndalimit kufitar, si dhe pikat, të cilat shihen si të mundshme për të ndërtuar qendra të pritjes ose

ndihmës për kalimin transit të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

- Rritjen e cilësisë së trajtimit të kërkesave dhe ankesave.

- Realizimin e një numri të konsiderueshëm inspektimesh monitoruese për të drejtat e emigrantëve të huaj dhe kthimeve të detyruara të qytetarëve shqiptarë, duke rekomanduar marrjen e masave për të garantuar kthimin në mënyrë njerëzore, duke respektuar plotësisht të drejtat themelore të emigrantëve shqiptarë dhe respektimin rigoroz të standardeve të BE-së.

Kuvendi kërkon që Avokati i Popullit për vitin 2019:

- të rrisë angazhimin në ndjekjen e përmbushjes së objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Agjenda 2030, me fokus të veçantë në çështje të tilla si: buxheti gjinor, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, mbrojtja e konsumatorëve, detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushat përkatëse dhe/ose rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë;

- të rrisë veprimtarinë e tij informuese dhe sensibilizuese lidhur me fushën e veprimtarisë së tij dhe rolin e institucionit;

- të rrisë angazhimin e tij në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke rritur bashkëpunimin me organizatat homologe;

- të publikojë rekomandimet e tij dhe t'i adresojë ato pranë institucioneve përgjegjëse dhe Kuvendit të Shqipërisë në kohë, dhe të informojë Kuvendin e Shqipërisë mbi ecurinë e zbatimit të tyre;

- të ndjekë shkallën e zbatimit të rekomandimeve, arsyet përse rekomandimet nuk janë përmbushur ose nuk janë pranuar dhe të informojë institucionet përgjegjëse dhe Kuvendin e Shqipërisë për masat që duhet të marrë;

- të krijojë dhe të bëjë publik, jo më vonë se 6-muaj nga data e miratimit të kësaj rezolute, një regjistër me ankesat/kërkesat e marra nga institucioni, si dhe të deklarojë statusin e tyre, duke respektuar rregullat e transparencës dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.

Miraturar në datën 30.5.2019.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR
VITIN 2018****Kuvendi i Shqipërisë:**

- duke njohur AKEP-in si autoritet i pavarur në mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

- duke konsideruar se gjatë vitit 2018 patëm një rritje të shkallës së përqendrimit të tregut të ofruesve të shërbimeve celulare, si rezultat i mbylljes së aktivitetit për ofrimin e këtyre shërbimeve nga shoqëria Plus Communication sh.a. më 31.12.2017;

- duke vlerësuar hapat pozitivë në lidhje me heqjen e tarifës së *roaming*-ut me Kosovën dhe më tej me vendet e Ballkanit;

- duke marrë parasysh se gjatë vitit 2018 tregu i komunikimeve elektronike u përball me një rënie të të ardhurave dhe fitimeve të operatorëve kryesorë të komunikimeve elektronike;

- duke konstatuar rritjen e ndjeshme të përdorimit të shërbimeve të aksesit *broadband* celular dhe rënia e përdorimit të shërbimeve tradicionale të thirrjeve dhe SMS-ve nga rrjete celulare, si dhe vijimin e rritjes së qëndrueshme të aksesit *broadband* nga rrjete fikse;

Vlerëson për vitin 2018:

- Kontributin konkret të dhënë nga AKEP-i në miratimin e ndryshimeve ligjore, të cilat i hapën rrugë lehtësimit të tarifave të *roaming*-ut me Kosovën dhe me vendet e tjera të rajonit, si dhe bashkëpunimin efikas të AKEP-it me të gjithë aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë gjatë këtij procesi.

- Si shumë pozitive dhe me ndikim të drejtpërdrejtë te konsumatori implementimin e ndryshimeve të miratuara lidhur me portabilitetin e numrave të pajtimtarëve. Këto ndryshime kanë reduktuar ndjeshëm kohën e portimit për konsumatorët dhe kanë lehtësuar procedurat.

- Si shumë pozitive dhe me ndikim të drejtpërdrejtë te konsumatori rikthimin e kohëzgjatjes mujore (30-ditore) të paketave të

ofruara nga operatorët, nga 28-ditore që ishin më parë.

- Punën e bërë për dhënien e një të drejte përdorimi të frekuencave të brezit 800 MHz, pas lirimit të këtij brezi dhe vënien e tij në dispozicion të shërbimeve të reja *broadband* mobile.

- Vendimmarrjen lidhur me rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, e cila ka ndikim në rritjen e përfitimeve të përdoruesve fundorë, si dhe promovimin e konkurrencës së ndershme bazuar në parimin e proporcionalitetit.

- Punën e bërë për përmirësim të plotë (*full upgrade*) të sistemit ATLAS, popullimin e sistemit me informacion mbi infrastrukturën pasive të operatorëve të telekomunikacioneve, si dhe dy ndërfaqet për operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike për publikun e gjerë.

- Ndryshimet e bëra në faqen e internetit www.akep.al këto ndryshime e kanë sjellë faqen më afër përdoruesit (*user friendly*), duke e vendosur konsumatorin në fokus të saj, ndërkohë linku i testimit të shpejtësisë së internetit duhet të bëhet funksional.

- Nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me disa institucione gjatë vitit 2018, në mënyrë të veçantë Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës, me të cilin duhet të rrisë më tej bashkëpunimin për një konkurrencë të ndershme dhe me rregulla të qarta loje në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare.

- Bashkëpunimin e ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) në luftën kundër piraterisë, si rezultat i të cilit u bë i mundur mbyllja e 80 *domain*-eve të paligjshme. Në të njëjtën kohë, nxiti AKEP-in për një bashkëpunim të mëtijshëm me AMA-n, si dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi mes dy institucioneve.

- Rritjen e numrit të inspektimeve në terren dhe atyre në distancë ndaj operatorëve të komunikimeve elektronike dhe postare, për të bërë të mundur që shërbimet e ofruara nga këto operatorë të jenë në përputhje me kushtet dhe rregullat e autorizuar.

Rekomandon për vitin 2019:



- t'i kushtojë vëmendje të veçantë vendimmarrjes, lidhur me “Analizën e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare”, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke bashkëpunuar ngushtë edhe me strukturat përkatëse të BE-së, si dhe duke iu referuar eksperiencave dhe ekspertizës së tyre;

- të bëjë një analizë të plotë të shkaqeve që çuan në daljen nga një treg i rregulluar i një operatori, nëse këto shkaqe lidhen me problematikën e vendimmarrjeve të rregullatorit apo dështimit në menaxhim të operatorit të fundit në treg dhe të reflektojë konkluzionet e kësaj analize;

- të vijojë punën, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse për ndjekjen e procedurave të tenderimit, lidhur me dhënien në përdorim edhe të dy brezave të tjerë të lirë të frekuencave 800 MHz, për t'i hapur rrugë futjes së teknologjive dhe shërbimeve të reja *broadband* mobile në nivel kombëtar;

- të bashkëpunojë ngushtë me MIE dhe me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) për lirimin e brezit 700 MHz, sipas rekomandimeve të BE-së, si dhe të kryejë paraprakisht një proces këshillimi lidhur me përdorimin e ardhshëm të brezit 700 MHz për operatorët e rrjeteve celulare;

- të punojë për nxitjen e implementimit të teknologjive të reja, nëpërmjet politikave rregullatore, të cilat sjellin rritjen e konkurrencës përmes rritjes së cilësisë, si dhe ndikojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira dhe më eficiente në tregun e komunikimeve elektronike;

- të bashkëpunojë me aktorët brenda vendit dhe ata ndërkombëtarë për implementimin me sukses të marrëveshjeve për lehtësimin e tarifave të *roaming* me Kosovën dhe më tej për vijimin e hapave dhe procedurave për lehtësimin e tarifave *roaming* me vendet e Ballkanit, sipas marrëveshjes së nënshkruar;

- të vijojë monitorimet, në bashkëpunim me Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR), lidhur me matjen e nivelit të rrezatimeve të telefonisë celulare, duke adresuar shqetësimin e publikut lidhur me ekspozimin ndaj valëve elektromagnetike të telefonave celularë, stacioneve bazë dhe transmetuesve të tyre, në mënyrë që niveli i këtyre rrezatimeve të mos tejkalojë pragun e sigurisë të përcaktuar nga Komisioni

Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jojonizuese (ICNIRP).;

- të bëjë, gjatë vitit 2019, një vlerësim të strukturës së tregjeve të shërbimeve postare, si dhe të ketë në fokus garantimin e Shërbimit Universal Postar dhe cilësisë së shërbimeve postare në të gjithë territorin e vendit, duke i kushtuar vëmendje zgjidhjes së problemeve të identifikuar me saktësinë e adresave dhe shpërndarjes së pakove në bashkëpunim edhe me institucionet përkatëse;

- të kërkojë me rigorozitet nga Posta Shqiptare dorëzimin e pakove (dërgesave) në adresën e individit, si një kërkesë ligjore, zbatimimi i së cilës duhet të përmbushet brenda një kohe sa më të shkurtër, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit;

- të marrë masa, brenda vitit 2019, që qytetarët (konsumatorët) të mos paguajnë tarifa dhe kosto shtesë për marrjen e pakove (dërgesave) nga Posta Shqiptare, praktikë sipas të cilës qytetarët duhet të shkojnë ta tërheqin pakon (dërgesën) në zyrat e postës kundrejt një pagese, në vend që ta marrin në adresë pakon (dërgesën);

- të intensifikojë aktivitetin e tij përmes grupit të punës, i ngritur në vitin 2018, në lidhje me kushtet teknike të zbatuara nga operatorët, si dhe të zbatojë masa administrative, sipas ligjit, në rastet e shkeljeve, duke konsideruar problemin e kabllave ajrore apo atyre të vendosura në shtyllëzimet elektrike, si dhe përdorimi i përbashkët i infrastrukturës, si një problem i cili vijon të mbetet shqetësues;

- të punojë për ngritjen e një regjistri “*Do Not Call Me*”, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, për të rregulluar aktivitetet e telemarketuesve që bëjnë thirrje telefonike të padëshiruara për individë privatë. Skema e regjistrimit do të mundësojë përdoruesit që të bëjnë “*opt-out*”, pra të mos marrin thirrje të pakërkuara nga kompanitë telemarketing;

- të vijojë punën, gjatë vitit 2019, për konsolidimin dhe reduktimin e rregulloreve ekzistuese, duke pasur parasysh jo vetëm rregulloret lidhur me mbrojtjen e konsumatorit, por edhe ato të cilat kanë të bëjnë me aktorët e tjerë në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare;

- të bashkëpunojë me MIE-n në përgatitjen dhe implementimin e akteve nënligjore të ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, si dhe të luajë



një rol proaktiv në lehtësimin dhe zbatimin e rregullave të reja që pritet të miratohen, me qëllim promovimin e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës, investimet e përbashkëta në rrjete dhe koordinimin e punëve civile, si dhe aksesin në rrjetin e brendshëm të ndërtesave;

- të marrë masa për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me rregullat e BE-së për sigurinë kibernetike, si dhe të rrisë më tej bashkëpunimin me Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike (ALCIRT), në lidhje me identifikimin e kërcënimeve të mundshme kibernetike dhe njoftimin e operatorëve në kohën e duhur për të marrë masa të menjëhershme;

- të bashkëpunojë me institucionet e tjera shtetërore për të bërë të mundur që deri në fund të vitit 2019 të finalizohet zbatimi në të gjithë Shqipërinë i përdorimit të numrit të emergjencës 112, përfshirë edhe identifikimin e vendndodhjes nga gjenerohet thirrja.

Miratuar në datën 30.5.2019.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

DEKRET
Nr. 11193, datë 29.5.2019

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Ilir Musli Murtezaj
2. Razie Ibrahim Murtezaj (Gashi)
3. Argjend Astrit Haxhismajli
4. Lorik Xhavit Muçaj
5. Astrit Besim Hasani

6. Šučo (Shuço/Shuqo) Bajram Selimović
7. Shqiptar Adem Demaçi
8. Arbërije Ibrahim Demaçi (Gashi)
9. Naim Ajvaz Abazi
10. Gabrijel Lekë Grabanica
11. Astrit Pal Lekaj
12. Skender Feriz Reçica
13. Didare Nazmi Reçica (Gostivari)
14. Flaka Agim Loxha
15. Shpati Valdet Zekaj
16. Kaltrina Ismet Kelmendi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 394, datë 9.5.2019

PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT
MULTIDISCIPLINAR, SI DHE
PROCEDURAT DHE ZBATIMIN E
STANDARDEVE TË SHËRBIMIT TË
PËRKUJDESJES ALTERNATIVE PËR
FËMIJË NË FAMILJE KUJDESTARE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikave 6 dhe 4, të nenit 24, të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

I. ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E KOMISIONEVE MULTIDISCIPLINORE TË
KUJDESTARISË

1. Në çdo Bashki ngrihet dhe funksionon komisioni multidisiplinor i kujdestarisë. Ky komision ka në përbërje:

- a) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashki;
- b) drejtuesin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës;
- c) punonjësin social të njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit ku ka gjendjen



civile familja e fëmijës që do të vendoset në kujdestari dhe/ose familja kujdestare;

d) jurist;

e) psikolog;

f) specialist për çështjet e arsimit në Bashki;

g) specialist për çështjet e shëndetësisë në Bashki.

2. Komisioni multidisiplinar i kujdestarisë është përgjegjës, për:

a) vlerësimin nëse familja që ka shprehur interesin për të qenë familje kujdestare, plotëson kushtet për të ofruar shërbimin e kujdestarisë në familje, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur;

b) merr vendim për miratimin e familjes kujdestare dhe përfshirjen e saj në regjistrin e familjeve kujdestare të Bashkisë;

c) përzgjedh familjen kujdestare ku do të vendoset fëmija, që ka të nevojshëm shërbimin e kujdesit në familje kujdestare, duke gjykuar mbi përshtatshmërinë sa më mirë të nevojave të fëmijës me familjen, e cila propozohet si familje kujdestare.

3. Në çdo bashki, struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të ketë ngritur dhe administrojë regjistrin e familjeve kujdestare, duke mundësuar kështu ekzistencën e disa familjeve të gatshme për të marrë në përkujdesje si raste emergjente fëmijë, për të cilët është dhënë masa emergjente mbrojtjes apo familje të gatshme për të vijuar procedurat në Gjykatë, për marrjen e kujdestarisë së përkohshme për fëmijën pa kujdes prindëror.

4. Komisioni multidisiplinar për vlerësimin e rasteve të kujdestarisë, mbledhet me kërkesën e strukturës përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijë në familje kujdestare dhe brenda këtyre afateve:

a) për miratimin e familjes kujdestare, brenda 30 ditëve nga paraqitja e dosjes nga struktura përgjegjëse.

b) për përzgjedhjen e familjes kujdestare ku do të vendoset fëmija, që ka të nevojshëm shërbimin e kujdestarisë, brenda një afati 7-ditor nga paraqitja e dosjes nga struktura përgjegjëse.

II. PROCEDURAT PËR VENDOSJEN E FËMIJËS NË SHËRBIMIN E PËRKUJDESJES ALTERNATIVE, NË FAMILJE KUJDESTARE

5. Procedura e vendosjes së fëmijës në përkujdesje alternative ndodh, kur:

a) prindërit e fëmijës kanë vdekur ose janë shpallur të vdekur nga gjykata, janë të panjohur, u është hequr përgjegjësia prindërore dhe janë në kushte nevojë për mbrojtje;

b) prindi ose kujdestari ligjor i të cilit është shoqëruar, ndaluar, arrestuar ose dënuar me heqje lirie dhe fëmija është në nevojë emergjente mbrojtjeje;

c) kur, në interesin e tij më të lartë, nuk mund të lihet në kujdesin prindëror, për shkak se rrezikohet integriteti i tij fizik, moral, psikologjik e emocional;

ç) është abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar ose neglizhuar;

d) është braktisur nga prindërit që në lindje ose është nën moshën 16 vjeç dhe askush nuk është duke u kujdesur për të;

dh) ka kryer një vepër penale dhe për shkak të moshës, nuk ka përgjegjësi penale;

e) ka, dyshohet ose akuzohet, ose është dënuar se ka kryer një vepër penale, është në gjendje të lirë dhe ka nevojë për mbrojtje.

6. Vendimi për ta vendosur fëmijën në familje kujdestare bazohet në një vlerësim shumë të kujdesshëm të nevojave të fëmijës dhe i arsyeve pse prindërit dhe familja e fëmijës nuk e kanë mundësinë t'i përgjigjen këtyre nevojave.

7. Gjatë procesit të vlerësimit për vendosjen e fëmijës në familje kujdestare punonjësi social përgjegjës siguron që:

a) vlerësimi për të vendosur fëmijën në shërbimin e kujdesit në familje kujdestare bëhet pjesë e Planit Individual të Fëmijës dhe diskutohet me të gjitha palët. Plani Individual detajon formën e kujdesit alternativ të nevojshëm për fëmijën, periudhën kohore, objektivat dhe qëllime të qarta, si dhe personat përgjegjës;

b) fëmija dhe prindërit e tij/saj dhe/ose kujdestarët ligjor dëgjohen dhe përfshihen aktivisht në këto procese;

c) në përputhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit fëmija përfshihet në përgatitjen e planit individual dhe në përcaktimin e objektivave dhe aktiviteteve;

ç) fëmija informohet dhe shpreh lirshëm dëshirat që ka vazhdimisht;

d) pjesë e planit individual është edhe mundësimi i kontakteve mes fëmijës dhe



prindërve biologjik, pjesëtarëve të familjes dhe personave që kanë rol të rëndësishëm në jetën e fëmijës;

dh) fëmijës dhe prindërve të fëmijës i jepet mbështetje maksimale gjatë procesit të marrjes së vendimit për kalimin në familje kujdestare, si dhe pas vendosjes së fëmijës në familjen kujdestare;

e) motrave dhe vëllezërve u jepet mundësia që të jetojnë bashkë, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë bie ndesh me interesin më të lartë të tyre. Nëse nuk vendosen në të njëjtën familje kujdestare, merren masa që të ruhen lidhjet dhe kontaktet mes tyre.

8. Procedurat e vendosjes së një fëmijë në kujdes alternative do të ndjekin të njëjtën logjikë si për menaxhimin e një rasti, të parashikuar në VKM-në respektive, që rrjedh nga ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, sipas udhëzuesit në Aneksin bashkëngjitur këtij udhëzimi.

9. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale, strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSMINISTËR I
SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ardiana Jaku**

**ANEKS
UDHËZUESI I OFRIMIT TË
PËRKUJDESIT ALTERNATIV PËR FËMIJË
NË FAMILJE KUJDESTARE**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzuesi është përcaktimi i procedurave, detyrave dhe përgjegjësi të strukturave përgjegjëse për zbatimin e standardeve në ofrimin e përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare.

2. Ky udhëzues përmban procedurat, që duhet të ndiqen për të vendosur fëmijët pa kujdes prindëror në shërbimin e përkujdesjes alternative në familje kujdestare dhe synon të njehsojë rregullat dhe procedurat të cilat duhet të

njihen, ndiqen dhe zbatohen nga të gjitha institucionet publike dhe jopublike që kanë detyrimin ligjor për ofrimin e këtij shërbimi.

3. Udhëzuesi mban në konsideratë faktin që familja është mjedisi më i mirë ku duhet të rriten fëmijët. Prindërit dhe fëmija janë aktorët dhe partnerët më të rëndësishëm për të përmirësuar situatën e fëmijës, por kur vërtetohet se familja nuk e mbron fëmijën apo në rastin më të keq, është abuzuesi i fëmijës, strukturat shtetërore kanë përgjegjësinë për të ndërhyrë edhe në familje.

**II. PARIMET E SHËRBIMIT TË
PËRKUJDESJES ALTERNATIVE PËR
FËMIJË NË FAMILJET KUJDESTARE**

4. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për të. Të gjitha vendimet që merren duhet të kenë si konsideratë kryesore interesin më të lartë të fëmijës.

5. Shërbimi ofrohet në përputhje me nevojat e fëmijës. Fëmijës i ofrohet shërbim kujdestarie duke marrë në konsideratë moshën, nivelin e zhvillimit, nevojat individuale të vlerësuara, gjendjen shëndetësore, aftësi të kufizuara të mundshme, gjininë, situatën familjare, kulturën, përkatësinë etnike dhe besimin fetar. Vlerësimi i nevojave të fëmijës kryhet përpara se fëmija të sistemohet në familjen kujdestare, me përjashtim të rasteve të emergjencës kur vlerësimi i nevojave të fëmijës bëhet pas sistemimit, por sa më shpejtë të jetë e mundur.

6. Konfidencialiteti. I gjithë informacioni i mbledhur do të përdoret vetëm për të përcaktuar nevojat e fëmijës dhe për ta mbrojtur atë nga dëmtimi, duke mbrojtur privatësinë dhe identitetin e fëmijës. Çdo e dhënë për çdo fëmijë duhet të mbahet e ruhet në një vend të sigurt.

7. Respektimi dhe promovimi i të drejtës së fëmijës për mbrojtje, përkujdesje dhe për t'u dëgjuar. Çdo fëmijë do të trajtohet me respekt dhe në përshtatje me zhvillimin e tij/saj individual, si dhe me nevojat dhe të drejtat për mbrojtje.

8. Pjesëmarrja në vendimmarrje. Fëmija i vendosur në familje kujdestare ka të drejtë të shprehë lirisht mendimin e tij/saj për të gjitha çështjet dhe vendimet që kanë të bëjnë me të. Në



bazë të informacionit që i ofrohet në përputhje me moshën ai/ajo bën zgjedhjet dhe ka pikëpamjet e veta të pavarura, përfshirë edhe ankimet të cilat duhen dëgjuar dhe konsideruar në të gjitha vendimet e marra lidhur me mirëqenien e tij/saj.

9. Mosdiskriminimi. Çdo fëmijë pa kujdes prindëror merr të njëjtin shërbim ose ndihmë dhe nuk do të diskriminohet si rezultat i statusit që ka, të etnisë, gjinisë, besimit fetar, moshës, vendndodhjes ose aftësisë.

10. Partneriteti dhe bashkëpunimi. Mbrojtja e fëmijës dhe promovimi i mirëqenies së tij/saj është një përgjegjësi e përbashkët dhe duhet të përfshijë gjatë procesit të vendimmarrjes të gjitha strukturat dhe shërbimet, fëmijët, familjen biologjike dhe familjen kujdestare.

11. Sigurimi i pavarësisë, integrimi social dhe pjesëmarrjes në jetën komunitare të fëmijës. Planet për fëmijën duhet të promovojnë aftësinë e familjes për t'u kujdesur në mënyrën e duhur, për të zhvilluar pavarësinë e tij/saj dhe për të inkurajuar integrimin social dhe pjesëmarrjen në komunitet.

12. Respektimi i përgjegjësisë, të drejtave dhe detyrave që kanë prindërit për fëmijën: Prindërit biologjik të fëmijës marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve dhe ruajnë kontaktet me fëmijën në një formë të dakordësuar në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

13. Prindërit kujdestarë të fëmijës marrin pjesë aktivisht dhe bashkëpunojnë me ekipin e profesionistëve të shërbimit të kujdesit alternativ për fëmijë në familje kujdestare, si dhe përfshihen në vendimmarrjet dhe planet e kujdesit për fëmijën. Familjet kujdestare sigurojnë një ambient të sigurt, të shëndetshëm dhe pozitiv për fëmijët.

Shkurtime:

VKM -Vendim i Këshillit të Ministrave

PIM - Plan individual i Mbrojtjes

MGJ - Marrëdhënie Gjaku

RKGJC - Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile

NJVNR - Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit

NJMF - Njësia e Mbrojtjes së fëmijëve

Përkujdesi alternativ

14. Fëmija i privuar në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga mjedisi i tij familjar, për

shkak se prindërit kanë vdekur ose mbi bazë të një vendimi gjyqësor apo kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis, për shkak të një mase mbrojtjeje, vendoset në përkujdesje alternative. Në zbatimin e kësaj mase, i jepet përparësi vendosjes së fëmijës në një mjedis familjar, sipas interesit më të lartë të fëmijës.

15. Rastet më tipike kur aplikohet përkujdesja alternative janë:

a) vendosja e fëmijës në familjen e ndonjërit nga të afërmit e tij, nëse kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës (kujdesi brenda lidhjes së gjakut, i cili mund të jetë formal ose jo formal);

b) vendosja e fëmijës në një familje kujdestare, në rast se prindërit biologjikë ose ndonjë i afërm tjetër nuk mund të kujdesen për fëmijën (kujdestari e përkohshme pa lidhje gjaku, është gjithmonë formale);

c) vendosja e fëmijës në një institucion të përkujdesit për fëmijët, për një periudhë sa më të shkurtër kohe.

16. Fëmija në nevojë për mbrojtje mund të vendoset në një nga format e mësipërme të përkujdesjes alternative për shkak të një mase mbrojtjeje.

17. Marrja e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative merr parasysh mosndarjen e motrave dhe vëllezërve.

18. Vendimi për marrjen e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative është i vlefshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata për konfirmimin ose jo të saj dhe ka të njëjtat efekte si vendimi i gjyqësor për kujdestarinë.

19. Personat apo institucioni, pranë të cilit vendoset fëmija në përkujdesje alternative, ka të njëjtat detyra, përgjegjësi dhe të drejta si ato të kujdestarit, të parashikuara në Kodin e Familjes, ndërsa prindërit e fëmijës, gjatë kohës së vlefshmërisë së masës së mbrojtjes, nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

20. Gjatë zbatimit të kësaj mase mbrojtëse, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ndjek me përparësi këto çështje:

a) trajtimin dhe gjendjen psiko-emocionale të fëmijës së vendosur në përkujdesje alternative;



b) ndihmën dhe krijimin e mundësive për prindërit për të mbajtur kontakte e marrëdhënie personale me fëmijët e tyre;

c) përgatitjen e dokumenteve përkatëse, të kërkuara nga gjykata në procesin gjyqësor, të konfirmimit ose jo të masës së mbrojtjes dhe të vendosjes së fëmijës në kujdestari;

ç) nevojën për ndryshimin apo heqjen e masës mbrojtëse, në varësi të progresit, kushteve dhe rrethanave të rastit.

21. Fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm, kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e masës së mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës. Ankimi shqyrtohet nga gjykata, së bashku me kërkesën për vlerësimin e masës nga gjykata.

22. Procedurat që ndiqen për zgjedhjen e njëres prej alternativave të parashikuara më sipër, bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes dhe ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe aktet nënligjore respektive.

Procedurat për parandalimin dhe masat emergjente të mbrojtjes¹

23. Fëmijët rriten në familjet e tyre biologjike dhe kur është e nevojshme, familjet dhe fëmijët mbështeten me shërbime të kujdesit shoqëror. Prindërit biologjikë kanë përgjegjësinë ligjore të kujdesen për fëmijët e tyre dhe të mundësojnë mirëqenien dhe sigurinë e tyre. Në rastet kur familja nuk e përmbush dot këtë rol, atëherë ndërhyrja shteti.

24. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin të mbështesin prindërit në detyrën e tyre për të mirërritur fëmijët përmes ngritjes dhe funksionimit të sistemit të mbrojtjes sociale, me qëllim që të parandalojnë rastet e rritjes së fëmijëve në varfëri, neglizhimit apo abuzimit me fëmijët dhe për të mbështetur prindërit që t'u garantojnë fëmijëve një mjedis të shëndetshëm, të ndjekin shkollën dhe t'u mundësojnë atyre rritje dhe jetesë të përshtatshme.

25. Masat kryesore, që struktura përgjegjëse në Bashki merr në funksion të garantimit të të drejtës së fëmijës për t'u rritur në familje janë:

a) Identifikim i hershëm: Njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes strukturave përgjegjëse duhet të kryejnë identifikim proaktiv i cili lejon trajtimin e të gjithë nevojave të fëmijëve duke parandaluar përshkallëzimin e problemeve. Identifikimi proaktiv realizohet kryesisht nëpërmjet punës së përditshme në terren. Identifikimi i fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo shërbime mund të kryhet nga vetë:

i. Fëmija/ përfituesi që kërkon mbështetjen (vetëreferimi).

ii. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës ose punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore kur konstatohet situata e nevojës për shërbime.

iii. Agjenci të tjera publike dhe jopublike që mund të identifikojnë dhe të referojnë raste me të cilat hyjnë në kontakt.

b) Mbështetja për fuqizimin e familjes biologjike të fëmijës: Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve dhe/ose punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore vlerësojnë nevojat e fëmijës dhe familjes dhe rast pas rasti i referojnë tek shërbimet specifike sociale me qëllim krijimin e kushteve për vijimin e jetesës së fëmijës në familje biologjike.

c) Kur janë ezauruar të gjitha përpjekjet për të mbështetur fëmijën dhe familjen me shërbime që synojnë garantimin e jetesës së përshtatshme të fëmijës në familjen biologjike dhe kur punonjësi i mbrojtjes së fëmijës vlerëson që fëmija është në situatë emergjente, vendoset për largimin e fëmijës nga familja biologjike dhe ofrimin e shërbimeve të tjera alternative në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, përmes marrjes së njëres prej masave të mbrojtjes:

i. masa emergjente e mbrojtjes, e cila është një masë e përkohshme mbrojtjeje për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative;

ii. masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative;

iii. masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar.

26. Në kuptimin e pikës 25/c/i, të këtij udhëzuesi, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës që informohet ose mendon në mënyrë të arsyeshme se fëmija ndodhet në një situatë urgjente, ka

¹ VKM nr. 578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes"



detyrimin e ndërhyrjes së menjëhershme, vlerësimit të nivelit të rrezikut ndaj të cilit është ekspozuar fëmija dhe ndërmerr veprimet e mëposhtme para se të vazhdohet më tej me procesin e menaxhimit të rastit:

a) komunikon me fëmijën për të kuptuar situatën e tij;

b) informon fëmijën për hapat që duhen ndjekur;

c) largon fëmijën nga vendndodhja aktuale dhe e strehon atë në strehën e përkohshme më të afërt;

ç) ndihmon fëmijën duke e dërguar në spital ose informon menjëherë policinë në rast se është e nevojshme;

d) i kërkon drejtorit të strukturës përgjegjëse në Bashki dhënien e masës së emergjente të mbrojtjes.

27. Masa emergjente e mbrojtjes merret nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, apo vendimi i gjykatës për konfirmimin e saj, dhe gjatë kohës së vlefshmërisë së kësaj mase prindërit e fëmijës nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore. Ajo është një masë e përkohshme mbrojtjeje, e cila vendoset për fëmijën që ndodhet në situatat e më poshtme:

a) kur fëmija vlerësohet të jetë në situatë rreziku të lartë dhe të menjëhershëm, për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo çdo formë dhune dhe për të cilin punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e Policisë së Shtetit apo prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku fëmija qëndron nuk është e sigurt për fëmijën;

b) është braktisur që në lindje nga prindërit ose është më i vogël se 16 vjeç dhe gjendet i braktisur në çdo lloj mjedisi;

c) është pa përkujdes prindëror, pasi prindërit e tij janë arrestuar, shtruar në spital ose ndodhen në situata të tilla, për shkak të të cilave ata nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

28. Largimi i fëmijës nga përkujdesja e familjes duhet të shihet si një masë e fundit dhe kur është e mundur, duhet të jetë i përkohshëm dhe me kohëzgjatje sa më të shkurtër. Vendimet për largime të tilla duhet të rivlerësohen rregullisht dhe rikthimi i fëmijës nën përkujdesjen prindërore, sapo shkaqet fillestare të

largimit të jenë zgjidhur ose eliminuar, duhet të jetë në interesin më të mirë të fëmijës.

29. Kushtet e vështira financiare dhe materiale, ose kushtet që shkaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të veçantë një varfëri të tillë, nuk duhet të shërbejnë kurrë si një justifikim i vetëm për largimin e një fëmije nga përkujdesja prindërore, për vendosjen e tij nën përkujdesje alternative, ose për parandalimin e rintegritit të tij/saj, por duhen parë si një sinjal për nevojën e ofrimit të mbështetjes së duhur për familjen.

30. I duhet kushtuar vëmendje promovimit dhe respektimit të të gjitha të drejtave të tjera në rastin e fëmijëve pa kujdes prindëror, përfshi por jo e kufizuar në të drejtën për arsimim, kujdes shëndetësor dhe të tjera shërbimeve bazë, të drejtën për identitet, liri apo besim fetare, të drejtën e gjuhës dhe të mbrojtjes së pronës dhe trashëgimisë.

31. Vëllezërit dhe motrat që aktualisht kanë lidhje midis tyre, parimisht nuk duhet të ndahen nga njëri-tjetri kur vendosen nën përkujdesje alternative nëse nuk ekziston ndonjë rrezik i qartë abuzimi apo justifikime të tjera në të mirë të interesave të fëmijëve. Në secilin rast, duhet bërë çdo përpjekje për t'i mundësuar vëllezërve dhe motrave që të ruajnë kontaktet me njëri-tjetrin, përveç rasteve kur kjo është në kundërshtim me dëshirën ose interesat e tyre.

Punonjësit socialë dhe të gjitha aktorët përgjegjës të përfshirë duhet të marrin në konsideratë:

32. Është e udhës, nëse është mundësia që fëmija të shprehë lirshëm mendimet dhe dëshirat e tij/saj (në bazë të marrjes së informacionit sa më të plotë të mundur), duke marrë në konsideratë pjekurinë e fëmijës dhe aftësinë për të vlerësuar pasojat e mundshme të çdo alternative të paraqitur.

33. Situata, qëndrimet, kapacitetet, mendimet dhe dëshirat e anëtarëve të familjes së fëmijës (prindërit, vëllezërit/motrat, të afërmit e rritur, “të tjerët” e afërt) dhe natyra e marrëdhënies së tyre emocionale me fëmijën.

34. Niveli i qëndrueshmërisë dhe sigurisë së ofruar nga mjedisi i përditshëm i fëmijës (qoftë me prindërit biologjikë, në kujdestarinë MGJ ose në kujdestari tjetër joformale, ose në kontekstin e kujdestarisë formale):



- aktualisht (vlerësimi i rrezikut të menjëhershëm);
- më parë në të njëjtin mjedis (vlerësimi i rrezikut të përgjithshëm);
- potencialisht në të njëjtin mjedis (p.sh., me çfarëdo ndërhyrje të nevojshme);
- potencialisht në çfarëdo konteksti tjetër kujdestarie që mund të merret në konsideratë.

35. Kur është e mundur konsideroni, efektet e ndarjes dhe potenciali për riintegrimin e familjes. Nevojat e veçanta të zhvillimit të fëmijës të lidhura me një paaftësi fizike ose mendore, ose me karakteristika ose rrethana të tjera të caktuara. Çështje të tjera të përshtatshme. Për shembull:

- Etnia e fëmijës, besimi fetar ku ka lindur / është rritur, kulturor dhe/ose gjuhësor, kështu që, mund të bëhen përpjekje për të siguruar vazhdimësinë e edukimit dhe, në parim, ruajtjen e lidhjeve me komunitetin e fëmijës. Përgatitja për tranzicionin për të jetuar i/e pavarur.

36. Rishikimi i përshtatshmërisë së çdo alternative të kujdestarisë për plotësimin e nevojave të fëmijës, duke pasur parasysh të gjitha konsideratat e mësipërme.

37. Ky vlerësim duhet të jetë në bazë të vendimit për kujdestarinë e fëmijës. Të njëjtat pyetje mbi interesin më të mirë të fëmijës duhet të përsëriten kurdoherë që rishikohet një alternativë kujdestarie. Ky vlerësim duhet të bëhet para se fëmija të zhvendoset apo të merret në kujdestari. Kur fëmija është në rrezik dhe kur është e nevojshme mbrojtja e menjëhershme e tij, procesi i plotë PIM duhet të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe kujdestaria duhet të jetë vetëm për një periudhë afatshkurtër.

38. Përgatitja për kujdestarinë

Para kujdestarisë është e rëndësishme të realizohet të paktën një takim me fëmijën dhe kujdestarin.

1. Përgatitja e fëmijës

- Shpjegoji fëmijës se ku po shkojnë dhe më do të jetojnë, pse do të jetojnë atje, sa kohë do të zgjasë kujdestaria dhe kur do të zhvendosen.

- Jep sa më shumë informacion në lidhje me familjen/kujdestarin me të cilët ata do të jetojnë.

- Përshkruaji fëmijës çdo pjesëtar të familjes, me emrat, moshën, rolet në familje. Nëse fëmija do të ribashkohet me familjen e tij është e rëndësishme të informohet në lidhje me çdo

ndryshim në familje që nga hera e fundit që aknë parë njëri tjetrin- lindjet, vdekjet etj.

- Shpjego çdo pritshmëri që familja kujdestare ka, p.sh., të ndihmuarit në punët e shtëpisë.

- Tregoji fëmijës që i ke treguar kujdestarit të tij për të, dhe në lidhje me hapat që duhet të plotësohen për kërkesat e veçanta që ai mund të ketë.

- Fëmija pyetet nëse ka ndonjë gjë tjetër që do të donte që familja/kujdestari ta dinte përpara se ata të zhvendosen në kujdestarinë e tyre, ose nëse ka ndonjë gjë të cilën nuk do të donin që familja/kujdestari të dinte ose që do të donin ta thoshin vetë.

- Tregoji fëmijës që janë bërë marrëveshjet që ata të jenë pjesë e familjes (p.sh., të gatuajnë për ta dhe të socializohen), të marrin pjesë në shërbime (p.sh., shërbimet në grup) dhe shpjego se ata mund të të raportojnë për çfarëdo problemi ose sfide që hasin.

- Informo fëmijën se sa shpesh do t'i vizitosh ata dhe kur do të jetë vizita e parë. Shpjego se ata do të kenë gjithmonë mundësinë që të flasin me ty privatisht në këto vizita dhe se si mund të të kontaktojnë kur është e nevojshme.

- Pyet nëse fëmija ka ndonjë pyetje ose shqetësim dhe përpiku t'u përgjigjesh atyre.

2. Përgatitja e familjes

- Tregoji kujdestarit të ri emrin e fëmijës, emrin e preferuar, moshën dhe gjininë, dhe çdo informacion të bekgraundit në lidhje me fëmijën dhe që fëmija ka rënë dakord që ta ndash me kujdestarin. Kujtoji kujdestarit se çfarëdo informacion i ndjeshëm është konfidencial.

- Konfirmo datën dhe orën e arritjes së fëmijës dhe kërkoji kujdestarit të përgatisë një mirëseardhje për fëmijën/ të përgatisë një festë lamtumire, nëse fëmija po largohet nga një kujdestari rezidenciale dhe është birësuar nga një familje.

- Konfirmo që fëmija do të ketë dhomën e tij për të fjetur dhe për të mbajtur sendet e tij.

- Shpjego çdo kërkesë në lidhje me ushqyerjen, shëndetin, dhe edukimin, dhe kujdestarinë që mund të ketë fëmija dhe punohet me kujdestarin se si mund të plotësohen këto kërkesa.

- Informo kujdestarin për çdo marrëveshje që është bërë, në mënyrë që fëmija të ndjekë shërbimet dhe shpjego se çfarë kërkohet nga ata,



në mënyrë që të mbështesin fëmijën të kenë akses në këto shërbime.

- Tregoji kujdestarit se çfarë informacioni i është dhënë fëmijës në lidhje me punët e shtëpisë dhe pritshmëritë e tyre.

- Informo kujdestarin se duhet të të informojnë ty për çdo informacion të ri që fëmija u jep atyre, çdo sfidë ose çështje që haset etj.

- Informo kujdestarin sesa shpesh do t'i vizitosh ata dhe kur do të jetë vizita e parë. Shpjego se do të flasësh gjithmonë privatisht me fëmijën.

- Këshillo kujdestarin se sit ë kontaktojë me ty dhe me kë të kontaktojë nëse nuk mund të

kontaktojë dot me ty.

3. Përfshirja e fëmijëve

Mekanizmat dhe strukturat mbështetëse do të ndihmojnë për t'u siguruar që zërat e fëmijëve të dëgjohen:

Në nivel kombëtar, duhet të ketë institucione të pavarura për të drejtat e njeriut si avokati i fëmijëve ose komisioneri i fëmijëve, i cili të jetë i aftë të mbështesë të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar në të gjitha situatat, duke përfshirë kujdestarinë MGJ.

Duhet të ketë mekanizma të përcaktuar për fëmijët në mënyrë që të komunikojnë ose raportojnë çështjet dhe/ose shqetësimet.

4. Kur merret në konsideratë përkujdesi alternativ:

- Të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, duhet të konsultohen në lidhje me vendimet se ku jetojnë. Nëse fëmijët janë shumë të vegjël për të folur, emocionet e tyre për kujdestarët mund të kuptohen nëse ata ndihen rehat me kujdestarin e tyre primar.

- Nëse një marrëveshje kujdestarie vlerësohet ose monitorohet, duhet të realizohen gjithmonë diskutime të veçuara me fëmijët në lidhje me kujdestarinë e tyre dhe gjithashtu në lidhje me këndvështrimet e tyre mbi shërbimet, të cilat mund të mbështesin fëmijët, familjet dhe kujdestarët e tyre.

- Të gjithë aktorët në komunitet duhet të sigurojnë që ka mënyra në të cilat fëmijët mund të ngrenë shqetësimet joformale. Shqetësimet e fëmijëve duhet të dëgjohen gjithmonë, të reagohej ndaj tyre dhe duke iu referuar një punonjësi social nëse është e nevojshme.

- Familjet kujdestare dhe të tjerët duhet të inkurajohen të ruajnë dokumentet e prejardhjes familjare dhe origjinës së fëmijës, kështu që fëmijët të kenë mundësi të kërkojnë për origjinën e tyre, nëse zgjedhin të bëjnë diçka të tillë.

Procedurat për evidentimin, vlerësimin dhe regjistrimin e familjes kujdestare²

39. Kriteret e përgjithshme të përcaktimit të familjeve kujdestare janë:

1. Vlerësimi i familjes kujdestare

Në vlerësimin e familjes kujdestare do të merren parasysh strukturat dhe dinamikat familjare, funksionimi i saj, pjekuria emocionale, cilësia e marrëdhënieve bashkëshortore, mundësia për t'u kujdesur për fëmijën/fëmijët në nevojë, si edhe gatishmëria për të qenë një familje kujdestare.

2. Moshë

Aplikuesit për të qenë prindër kujdestarë, nuk duhet të jenë më pak se 25 vjeç dhe më shumë se 65 vjeç.

3. Marrëdhëniet me ligjin

Aplikuesit për të qenë prindër kujdestarë dhe anëtarët e familjes së tyre, duhet të mos kenë kryer vepra kriminale, si edhe referencat nga komuniteti të jenë të qarta për sjellje të pranueshme etike dhe moral (dëshmitë përkatëse). Aplikuesit për të qenë prindër kujdestar janë të gjithë personat, të cilët nuk përjashtohen në bazë të Kodit të Familjes dhe VKM-së për kujdestarinë.

4. Statusi financiar

Familja kujdestare duhet të ketë të ardhura të vazhdueshme dhe në masë të mjaftueshme, për të plotësuar nevojat e familjes.

5. Motivimi për të qenë prindër kujdestare

Prindërit kujdestarë, si dhe të gjithë pjesëtarët e familjes, duhet të jenë të motivuar për të siguruar mbrojtje, dashuri dhe kujdesje familjare për fëmijën/ fëmijët.

6. Aftësitë prindërore

Aplikantët duhet të demonstrojnë aftësi kujdesi dhe edukuese, durim, mirëkuptim, altruizëm, afeksion, fleksibilitet dhe empati ndaj nevojave të fëmijës.

² Pikat 3–19 e VKM-së nr. 149, datë 13.3.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”.



7. Edukimi

Prindërit kujdestarë duhet të kenë kapacitete edukimi të nevojshme, për të siguruar një edukim sa më të mirë të fëmijës /fëmijëve.

8. Shëndeti

Të gjithë pjesëtarët e familjes duhet të gëzojnë shëndet të mirë fizik dhe mendor.

9. Strehimi

Kujdestarët duhet të kenë strehim (sipërfaqe banimi), që të garantojë një mjedis të sigurt dhe kushte higjienike, të nevojshme këto për një shëndet të mirë dhe mirëritje të fëmijës/fëmijëve. Shtëpia duhet të ketë një dhomë të veçantë për fëmijët dhe krevat për çdo fëmijë.

10. Qëndrime jodiskriminuese

Aplikantët për të qenë prindër kujdestarë, nuk duhet të kenë qëndrimeve diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara apo minoriteteve etnike dhe duhet të respektojë ushtrimin e besimit fetar të fëmijës/fëmijëve.

11. Infrastruktura e komunitetit

Komuniteti në të cilin jeton aplikanti, duhet t'u ofrojë fëmijëve të vendosur në kujdestari mundësi për: edukim; kujdes shëndetësor; transport; mjedise zbavitëse.

12. Përfshirja e anëtarëve të familjes kujdestare

Përfshirja e të gjithë anëtarëve të familjes në marrjen e vendimit për të qenë një familje kujdestare është e domosdoshme.

13. Marrëdhëniet e familjes kujdestare me institucionet e përfshira në procesin e kujdestarisë

Familja kujdestare duhet të jetë gjithmonë e gatshme dhe e hapur për një bashkëpunim të ngushtë me Sektorin e Shërbimeve Sociale/Agjenci, Organizata, Gjykatën, Inspektoratin Shtetëror të Shërbimeve Shoqërore etj.

14. Marrëdhëniet e familjes kujdestare me familjen e origjinës

Të kuptojë, të pranojë dhe zbatojë parimet e bashkëpunimit me familjen biologjike të fëmijës.

40. Në çdo Bashki struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duhet të ketë ngritur dhe administrojë regjistrin e familjeve kujdestare, duke mundësuar kështu ekzistencën e disa familjeve, të gatshme për të marrë në përkujdesje si raste emergjente, fëmijë për të cilët është

dhënë masa emergjente mbrojtjes apo familje të gatshme për të vijuar procedurat në Gjykatë, për marrjen e kujdestarisë së përkohshme për fëmijën pa kujdes prindëror.

41. Struktura përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ në çdo Bashki, planifikon fonde dhe ndërmerr fushata të vazhdueshme informimi dhe komunikimi me komunitetin, me qëllim identifikimin e familjeve të mundshme, për të qenë familje kujdestare. Struktura përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijë në familje kujdestare është:

a) struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë ku banon fëmija;

b) Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit në njësinë administrative të bashkisë, ku banon fëmija;

c) subjekti publik ose jopublik ofrues i shërbimeve të kujdesit shoqëror ku është vendosur përkohësisht fëmija; apo

ç) organizatat jofitimprurëse që ushtrojnë aktivitet në fushën e shërbimeve të përkujdesit alternativ për fëmijë.

42. Për t'u përcaktuar si familje e gatshme për të qenë familje kujdestare, një familje duhet të plotësojë këto kritere³:

a) të ketë shfaqur interesin për të ofruar shërbimin e përkujdesjes alternative;

b) anëtarët e familjes të jenë të motivuar për të qenë familje kujdestare;

c) anëtarët e familjes të mos kenë qenë të dënuar për vepra penale apo dhunë në familje, me vendim të formës së prerë nga gjykata;

ç) prindërit kujdestarë të kenë aftësi për të kryer detyrën e kujdestarit;

d) prindërit kujdestarë dhe të gjithë anëtarët e familjes të vërtetojnë me raport mjekësor nga komisioni mjeko-ligjor që janë të aftë për të ofruar këtë shërbim dhe se nuk mbartin sëmundje të transmetueshme;

dh) të strehojnë dhe garantojnë mjedis familjar të sigurt për fëmijën;

e) anëtarët e familjes të mos kenë qëndrime diskriminuese ndaj fëmijëve, fëmijëve me aftësi

³ Pika 5 e VKM-së nr. 149, datë 13.3.2018 "Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare".



të kufizuara apo fëmijëve që i përkasin një minoriteti të caktuar;

ë) të respektojnë ushtrimin e besimit fetar të fëmijës/fëmijëve, apo të gjitha gjendjet e fëmijës sipas njërit apo disa prej shkaqeve të parashikuara në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi;

f) prindërit kujdestarë të kenë kuptim të qartë dhe të janë të gatshëm të zbatojnë parimin e veprimit në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;

g) prindërit kujdestarë të jenë të gatshëm për të bashkëpunuar me familjen biologjike të fëmijës dhe me strukturën përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ;

gj) prindërit kujdestarë nuk kanë humbur ose u është hequr përgjegjësia prindërore, ose u është hequr detyra e kujdestarit në një rast tjetër;

h) prindërit kujdestarë të jenë nën moshën 65 vjeç;

i) prindërit kujdestarë të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në jo më shumë se tre fëmijë;

43. Çdo familje e interesuar për të qenë familje kujdestare, duhet të shprehë interesin duke paraqitur një kërkesë pranë strukturës përgjegjëse. Kërkesa përmban informacion për familjen sipas formularit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi. Kërkesës i bashkëlidhen dokumenti/et e identifikimit të prindërve të familjes.

44. Punonjësi social i strukturës përgjegjëse (në vijim “punonjësi social përgjegjës”), bën vlerësimin paraprak të familjeve të interesuara, në bazë të kriterëve të vlerësimit të parashikuara në pikën 42 të këtij udhëzuesi dhe fton familjet e përzgjedhura të ndjekin sesionin e informimit mbi shërbimin e kujdestarisë.

45. Sesioni informues konsiston në dhënien e informacionit të hollësishëm për përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e familjes kujdestare.

46. Në përfundim të sesionit informues punonjësi social përgjegjës, fton familjen kujdestare të konfirmojë më shkrim, interesin për të vijuar me procedurën e regjistrimit si familje kujdestare.

47. Prindërit kujdestarë të interesuar ftohen nga punonjësi social përgjegjës dhe zhvillojnë një intervistë të strukturuar sipas formularit nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij

udhëzuesi. Intervista synon të marrë informacion të detajuar mbi kontekstin familjar, edukativ dhe social të familjes aplikuese, si dhe të kushteve dhe mundësive që ka familja për të krijuar një mjedis të përshtatshëm familjar për mirërritjen e fëmijës.

48. Familjes së interesuar i kërkohet të paraqesë pranë punonjësit social përgjegjës këto dokumente plotësuese:

a) raportin mjeko-ligjor, që vërteton se prindërit e familjes janë të aftë fizikisht dhe mendërisht;

b) referenca për familjen nga 2 persona (njëri prej të cilëve duhet të jetë një përfaqësues i komunitetit në të cilin jeton familja).

49. Punonjësi social përgjegjës, mbledh nëpërmjet paraqitjes të kërkesës në institucionet respektive ose nëpërmjet aksesit në portalin elektronik, për llogari të personave fizik sipas legjislacionit në fuqi edhe këto dokumente mbi familjen e interesuar:

a) përbërjen familjare nga Regjistri i Gjendjes Civile;

b) vërtetimin e gjendjes gjyqësore për anëtarët e familjes mbi 18 vjeç;

c) të ardhurat e familjes;

ç) pasuritë e paluajtshme të familjes;

d) vërtetim nga strukturat e policisë, nëse ka pasur denoncime për dhunë në familje apo probleme të tjera me komunitetin;

dh) verifikim social ekonomik të familjes nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative.

50. Mbas plotësimit të dokumentacionit, punonjësi social përgjegjës, në bashkëpunim me psikologun, kryen vlerësimin e mëtejshëm të familjes kujdestare të interesuar. Për kryerjen e vlerësimit punonjësi social përgjegjës dhe psikologu, mbështeten të të dhënat e mbledhura sipas pikave 43, 47, 48, dhe 49 të këtij udhëzuesi, si dhe informacionet që marrin nga:

a) vizitat në banesën e aplikantit, për të verifikuar kushtet e jetesës së familjes kërkuese;

b) takimet individuale dhe në grup me të gjithë anëtarët e familjes së aplikantit;

c) intervistimit të personave të paraqitur nga aplikanti si referencë;

d) intervistimit të specialistëve të tjerë, si psikologë, punonjës të policisë, përfaqësues të organeve të pushtetit vendor në vendbanimin e familjes kërkuese, punëdhënësin e



bashkëshortit/es, përfaqësues të institucioneve arsimore, përfaqësues të komunitetit.

51. Nëse sipas vlerësimit, gjykohet se familja është e përshtatshme për të qenë familje kujdestare, prindërit kujdestarë të interesuar, i nënshtrohen trajnimit për prindër kujdestarë, të organizuar nga struktura përgjegjëse dhe gjatë këtij procesi vlerësohen kapaciteti, aftësitë dhe shprehitë e tyre si prindër kujdestar. Kryerja e trajnimit dokumentohet me një procesverbal ose me certifikatën e trajnimit.

52. Pas përfundimit të trajnimit, punonjësi social përgjegjës dhe psikologu përgatisin Raportin e Vlerësimit të Familjes Kujdestare (referim formulari nr. 5).

53. Dokumentet e mbledhura sipas pikave 43, 47, 48, 49, 50, 51, dhe 52 të këtij udhëzuesi sistemohen nga punonjësi social përgjegjës, në dosjen e familjes kujdestare të interesuar dhe dërgohen nga struktura përgjegjëse për vendimmarrje në Komisionin Multidisiplinar në bashkinë përkatëse.

54. Komisioni Multidisiplinar mblidhet për të shqyrtuar rastin, bën vlerësimin nëse familja plotëson ose jo kushtet për të ofruar shërbimin e kujdestarisë në familje, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe merr vendim për miratimin e familjes kujdestare brenda 30 ditëve nga paraqitja e dosjes sipas pikës 53 të këtij udhëzuesi

55. Vendimi i Komisionit Multidisiplinar i përcillet strukturës përgjegjëse që ka paraqitur dokumentacionin pranë saj, si dhe strukturës së shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki dhe Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit në njësinë administrative ku banon familja kujdestare. Struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki regjistron familjen në regjistrin e familjeve kujdestare që ngre dhe administron.

Komisionimi dhe vendosja e fëmijës pa kujdës prindëror në familjen kujdestare⁴

56. Pas sigurimit të përkujdesit të menjëhershëm sipas pikës 27 të këtij udhëzuesi,

Njësia e Mbrojtjes të Fëmijëve i referon rastin strukturës përgjegjëse ku ka vendbanimin fëmija.

58. Struktura përgjegjëse, me marrjen e referimit, sipas pikës 56 të këtij udhëzuesi, mbledh të dhëna për fëmijën pa kujdes prindëror dhe familjen biologjike të tij. Informacioni mblidhet dhe evidentohet, sipas formularit nr. 3 dhe nr. 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi

59. Vendimi për ta vendosur fëmijën në familje kujdestare bazohet në një vlerësim shumë të kujdesshëm të nevojave të fëmijës dhe i arsyeve pse prindërit dhe familja e fëmijës nuk e kanë mundësinë t'i përgjigjen këtyre nevojave.

60. Në kuptimin e pikës 25/c/ii të këtij udhëzuesi, vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative është një masë e përkohshme mbrojtjeje për fëmijën pa përkujdesje prindërore dhe kur për mbrojtjen e tij është i nevojshëm strehimi apo vendosja e tij në përkujdesje alternative, duke ndjekur këtë radhë:

a) pranë një të afërmi të fëmijës;

b) pranë një familjeje kujdestare;

c) në një institucion rezidencial të përkujdesjes, kur nuk është e mundur asnjë nga alternativat e mësipërme;

61. Në përfundim të procesit të mbledhjes së informacionit punonjësi social përgjegjës harton Raportin e Vlerësimit të Rastit. Raporti i Vlerësimit të Rastit përfshin vlerësimin e fëmijës pa kujdes prindëror dhe vlerësimin e familjes të tij biologjike dhe përmban të paktën këto informacione:

a) moshën dhe gjendjen civile të fëmijës;

b) marrëdhëniet familjare dhe sociale të fëmijës;

c) gjendjen shëndetësore të fëmijës;

ç) nivelin e arsimimit të fëmijës;

d) temperamentin dhe interesat e shfaqura të fëmijës;

dh) nevoja të veçanta, probleme të shfaqura të fëmijës;

e) arsyet për të cilat fëmija duhet të vendoset në shërbim kujdestarie;

ë) moshën e prindërve biologjikë;

f) vendbanimin e prindërve biologjikë;

g) punësimin dhe të ardhurat financiare të prindërve biologjikë;

gj) nivelin e arsimimit të pjesëtarëve të familjes biologjike;

⁴ Pikat 22–41 e VKM-së nr. 149, datë 13.3.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”.



h) kushtet e strehimit të familjes biologjike;
i) gjendjen shëndetësore të anëtarëve të familjes biologjike;

j) gjendjen psiko-sociale dhe ligjore të pjesëtarëve të familjes biologjike;

k) deklaratën e prindit/prindërve biologjikë kur prindi/prindërit jetojnë, në të cilën shprehet aprovimi për vendosjen e fëmijës në familje kujdestare, me përjashtim të rasteve kur për fëmijën është marrë një nga masat e mbrojtjes të parashikuara në nenin 55 të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

62. Punonjësi social përgjegjës, gjithashtu plotëson dosjen e fëmijës me këto dokumente:

a) certifikatën personale të fëmijës me fotografi;

b) 4 fotografi të fëmijës;

c) certifikatën familjare të fëmijës;

ç) raportin mjeko-ligjor për gjendjen shëndetësore dhe mendore të fëmijës;

d) kopjen e fletores së fëmijës për vaksinimet e kryera;

dh) dëftesën shkollore për fëmijën, nëse fëmija frekuenton një të tillë;

e) vërtetimin nga institucioni i përkujdesjes shoqërore, nëse fëmija është vendosur në një të tillë.

63. Plotësimi i dosjes, përveç në rastin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 62 të këtij udhëzuesi, të sigurohet nëpërmjet kërimit të dokumentacionit në institucionet respektive ose nëpërmjet aksesit në portalin elektronik për llogari të personave fizik sipas legjislacionit në fuqi.

64. Dosja e rastit që përfshin dokumentet e mbledhura sipas 58, 61 dhe 62 të këtij udhëzuesi, dërgohet nga struktura përgjegjëse Komisionit Multidisiplinar të kujdestarisë në bashkinë që ka bërë referimin, brenda një afati 15-ditor nga referimi.

65. Komisioni Multidisiplinar brenda një jave nga paraqitja e dosjes sipas pikës 64 të këtij udhëzuesi, përzgjedh dhe propozon një nga familjet kujdestare nga Regjistri i Familjeve Kujdestare të krijuar sipas pikës 55 të këtij udhëzuesi.

Përshtatshmëria

66. Komisioni Multidisiplinar përzgjedh familjen kujdestare, sipas pikës 65 të këtij udhëzuesi duke gjykuar mbi përshtatshmërinë sa

më mirë të nevojave të fëmijës me familjen që propozohet si familje kujdestare.

67. Përshtatshmëria ndërmjet familjes kujdestare dhe fëmijës bazohet në vlerësimin e zhvillimit të personalitetit të fëmijës, në kontekstin familjar edukativ e social, vlerësimin e kushteve dhe të përshtatshmërisë së fëmijës me familjen kujdestare të ardhshme, si dhe në kriteret e mëposhtme:

a) Për fëmijën: mosha, temperament, interesat, marrëdhëniet me fëmijët e tjerë dhe nevoja të veçanta që mund të ketë;

b) Për familjen biologjike: mosha, temperament, profesioni/punësimi, strehimi, interesat, niveli i edukimit;

c) Për familjen kujdestare: mosha, temperament, punësimi/profesioni, aftësitë, interesat, niveli edukativ, qëndrimet kundrejt kulturave të tjera, statusi ligjor, kompetencat profesionale, preferencat ndaj fëmijëve potencialë për shërbim kujdestarie, gatishmëria, banimi (distanca nga familja biologjike), fëmijët e tjerë të familjes.

68. Me marrjen e njoftimit nga Komisioni Multidisiplinar, sipas pikës 66 të këtij udhëzuesi, struktura përgjegjëse njofton familjen kujdestare për vendimin që ka marrë për përzgjedhjen si familje kujdestare dhe kjo e fundit i paraqet deklaratën e gatishmërisë për të marrë fëmijën në përkujdesje.

69. Struktura përgjegjëse paraqet kërkesën në Gjykatë sipas nenit 264 të Kodit të Familjes.⁵

70. Gjykata vendos sipas dispozitave të Kodit të Familjes për vendosjen e fëmijës në një Familje kujdestare.

71. Struktura përgjegjëse që ka ndjekur procedurën përkatëse në Gjykatë depoziton një kopje të vendimit të Gjykatës pranë NJVNR-së ku banon familja kujdestare.

⁵ Neni 264 i Kodit të Familjes; e drejta për paraqitjen e kërkesës - të drejtën për paraqitjen e kërkesës në gjykatë për kujdestar mbi të miturin e kanë:

a) të afërmit e fëmijës së mitur;

b) cilido që merr njoftim për mbetjen e fëmijës pa prindër ose për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur;

c) vetë i mituri që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç;

ç) prokurori;

d) noteri, i cili në çeljen e një testamenti vihet në dijeni për caktimin e një kujdestari.



72. Me marrjen e vendimit, sipas pikës 70 të këtij udhëzuesi, punonjësi social përgjegjës bën përgatitjen paraprake të fëmijës, që përfshin:

- a) informimin e fëmijës (bazuar në nivelin e të kuptuarit dhe moshën);
- b) përshtatjen graduale të fëmijës me familjen kujdestare, nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta të fëmijës me familjen kujdestare, vizitave dhe takimeve, numri i të cilave përcaktohet dhe realizohet rast pas rasti dhe është i kushtëzuar nga ritmi individual i përshtatjes së çdo fëmije;

- c) sistemimin e fëmijës në familjen kujdestare;
- ç) hartimin e një plani individual për fëmijën;
- d) hartimin e një plani për fuqizimin e familjes biologjike, për mundësimin e rikthimit të fëmijës.

Monitorimi i fëmijës në familjen kujdestare

73. Gjatë vizitave monitoruese punonjësi social përgjegjës dhe psikologu sigurohen që:

- a) fëmija trajtohet me ngrohtësi, mirëkuptim, respekt dhe ndihet i mbrojtur dhe i mbështetur nga familja kujdestare;
- b) prindërit kujdestarë komunikojnë hapur dhe me respekt me fëmijën;
- c) fëmija është i mbrojtur nga abuzimi dhe shfrytëzimi;
- ç) fëmija merr kujdesin e duhur shëndetësor;
- d) fëmija ushqehet shëndetshëm;
- dh) fëmija ndjek sistemin arsimor në përputhje me kapacitetin, rrethanat dhe nevojat për zhvillim, si dhe mbështetet në procesin e të mësuarit;
- e) fëmija ka mundësi të luaj në një mjedis të mbrojtur dhe stimulus, i cili mbështet miqësinë me fëmijët e tjerë, si dhe nevojat individuale për zhvillim shoqëror;
- f) fëmija mbështetet për të arritur zhvillimin e duhur fizik, social dhe emocional;
- g) fëmijës i janë krijuar kushtet për të ruajtur kontaktet me prindërit biologjik apo pjesëtarët e familjes në përputhje me përcaktimet në Planin Individual;
- h) fëmija përfshihet në marrjen e vendimeve brenda familjes dhe për çështje që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tij/saj;
- i) fëmija është i informuar për të drejtat dhe përgjegjësitë brenda familjes;
- j) fëmija është i informuar mbi mekanizmin e ankimit dhe raportimit, në raste të abuzimit

apo neglizhimit. Në përputhje me moshën dhe pjekurinë, fëmija trajnohet për t'i përdorur këto procedura.

74. Gjatë periudhës së jetesës së fëmijës në familjen kujdestare, punonjësi social përgjegjës mundëson:

- a) përfshirjen e fëmijës, në përputhje me moshën dhe shkallën e të kuptuarit, në përgatitjen dhe rishikimin e vazhdueshëm të Planit Individual dhe të Planit të zhvillimit të fëmijës.

- b) takime individuale me fëmijën.

- c) vizita monitoruese në ambientin ku jeton me familjen kujdestare.

- d) mbështetje për prindërit kujdestarë, sa herë që ata e kanë të nevojshme, për të kapërcyer vështirësi të mundshme, që krijohen me fëmijën.

75. Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit ose struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror, për bashkitë që nuk kanë njësi të vlerësimit dhe referimit të rastit, monitoron në vazhdimësi familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari, nëpërmjet kryerjes së vizitave të monitorimit në shtëpi apo gjatë veprimtarisë normale të familjes.

76. Vizitat e monitorimit, sipas pikës 75, bëhen çdo 2 javë në 3 muajt e parë, për familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari dhe më pas çdo muaj. Rezultatet e çdo vizite dokumentohen dhe përfshihen në dosjen përkatëse të fëmijës.

77. Drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror monitorojnë çdo 3 muaj proceset e punës së punonjësit social të njësive të qeverisjes vendore dhe bëjnë monitorimin e fëmijëve të vendosur në familje kujdestare.

A është kujdestari (MGJ), ose a janë të gjithë pjesëtarët e familjes të gatshëm të kujdesen për fëmijën? (informacioni i mbledhur nga intervistat me secilin pjesëtar të familjes, duke përfshirë dhe fëmijët)	PO JO Përmbledhje e motivimit të secilit pjesëtar të familjes: Fotot e secilit pjesëtar të familjes janë të përfshira në paketën e vlerësimit.
A janë ata të gatshëm të sigurojnë kujdestari më afatgjatë (më shumë se 12 javë)?	PO JO Komentet:
A është dakord familja kujdestare (MGJ) që fëmija të rikthehet në familjen e tij biologjike nëse ata janë të aftë të kujdesen për të përsëri ose, nëse ribashkimi me familjen është i pamundur, a janë ata dakord me kujdestarinë e përhershme të fëmijës?	PO JO Komentet:
Rezultatet e vlerësimeve të familjes	
A është familja e aftë të kujdeset për fëmijën me ose pa një mbështetje minimale?	PO JO Çfarë pune bëjnë? Si janë kushtet në shtëpi? (ka ujë, lagështi, hapësirë, kontratë e sigurt/e qëndrueshme e qerasë) Përmbledhje e vlerësimit: Fotokopje e vërtetimit të pagës
A ka mundësi familja të sigurojë shkollimin e fëmijës?	PO JO Përmbledhje e vlerësimit:
A ka familja një gjendje të qëndrueshme shëndetësore dhe psikosociale?	PO JO Përmbledhje e vlerësimit: Fotokopje të certifikatave mjekësore për të gjithë anëtarët e familjes
A ka kujdestari MGJ eksperiencë në prindërim?	PO JO Nëse po, përshkruaj:



A janë prindërit të aftë të mësojnë fëmijën se si të sillet?	PO JO Nëse po, përshkruaj: Nëse jo, a ka prova të disiplinimit apo ndëshkimit të rëndë të mëparshëm?
A do të jetë i sigurt fëmija në këtë familje?	PO JO Nëse jo, shpjego faktorët e mundshëm riskues dhe lëndues.
A janë prindërit të dashur dhe të ngrohtë me fëmijën?	PO JO Nëse po, përshkruaj. Nëse jo, cilat janë shqetësimet.
A ka role dhe përgjegjësi të ndara në shtëpi?	PO JO Nëse po, përshkruaj rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të ndryshëm të shtëpisë. Përshkruaj rolin dhe përgjegjësitë e fëmijës.
A është familja e izoluar në aspektin social?	PO JO Nëse po, shpjego.
A ka ndonjë shqetësim në lidhje me zhvillimin fizik; ushqyerjen, aftësitë motorike, të folur dhe komunikimin, zhvillimin emocional dhe social, atashimet, vetëbesimin, lumturinë, sjelljen e fëmijës në kujdestarinë MGJ?	PO JO Nëse po, shpjego.

PËRFUNDIMET, VENDIMET DHE VEPRIMI

Tani vlerësimi ka përfunduar dhe duhet të raportosh përfundimet dhe vendimet. Puno me fëmijën dhe/ose prindin/kujdestarin.

Njerëzit e pranishëm në vlerësimin e marrjes së vendimeve.

Cilat janë sfidat që duhet të kapërcejë fëmija që të vazhdojë të jetojë me familjen e tij/saj të zgjerua.

A do të jetë i riskuar për t'u lënduar fëmija nëse vazhdon të jetojë në familjen kujdestare MGJ? Nëse po, përshkruaj dhe paraqit të dhënat/provat.

Plani i veprimit

Komentet dhe shqetësimet e fëmijës në lidhje me vlerësimin dhe planin e veprimit

Komentet e prindit biologjik në lidhje me vlerësimin dhe planin e veprimit

Komentet e kujdestarit MGJ në lidhje me vlerësimin dhe planin e veprimit



Cili është plani i veprimi?

Shpjego se pse ke zgjedhur këtë plan veprimi dhe çfarë synon ai të arrijë

Veprimi	Nga kush

Firmosur nga kujdestari MGJ Data.....

Firmosur nga prindi/kujdestari Data.....

Firmosur nga fëmija (nëse është e mundur) Data

Punonjësi social Data.....

Aprovuar:

NJOFTIM

Nr. 7815, datë 29.5.2019

PËR HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE ME GJERMANINË

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin Universitar të Tiranë, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza III”, ka hyrë në fuqi në datën 20.5.2019.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

KËRKESË

Nr. 4743/2, datë 30.5.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksion i rrugës Plastmas-Karbunarë”, Lushnjë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 25 480 (njëzet e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë.

ZËVENDESMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTTIT: “RIKONSTRUKSION I RRUGËS PLASTMAS-KARBUNARË”, LUSHNJË

Nr.	Emër mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Sipërfaqja shpronësimi	Çmimi tokë arë / m ²	Vlera totale / lekë	Shënime Konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja
					tokë arë / m ²			
1	Hysni Selman Demo	2087	618/10	500	70	364	25,480	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Vlera totale e shpronësimit							25,480	

VENDIM
Nr. 730, datë 30.5.2019

**DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA
SOCIALISTE PËR INTEGRIM, QARKU
TIRANË, PËR PLOTËSIMIN E
VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA
KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 30.5.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;
Denar Biba: zv.kryetar;
Bledar Skënderi: anëtar;
Edlira Jorgaqi: anëtare;
Rezarta Bitri: anëtare,
shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Luan Mersin Rama.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175 pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore, qarku Tiranë, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 5 (pesë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Tiranë, është numri rendor 1 (një) znj. Klajda Theodhoraq Gjoshaj, numri rendor 2 (dy) znj. Kejdi Fatmir Mehmetaj, numri rendor 3 (tre) znj. Florda Fadajev Kërpaçi, numri rendor 4 (katër) z. Endrit Vullnetar Braimllari dhe numri rendor 5 (pesë) z. Luan Mersin Rama.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Tiranë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. KQZ-ja, me vendimin nr. 288, datë 5.5.2017 “Për miratimin e listave



shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2017”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për 12 zonat zgjedhore, si dhe vendosi sanksion administrativ në masën 1.000.000 (një milion) lekë, për zonën zgjedhore qarku Tiranë.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në zonën zgjedhore qarku Tiranë, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Tiranë, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 6 (gjashtë), 7 (shtatë), 9 (nëntë), 10 (dhjetë), 11 (njëmbëdhjetë) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 80, datë 20.3.2019, si dhe vendimin nr. 102, datë 27.3.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 33, datë 4.3.2019, ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit z. Ylli Vesel Shehu, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Floida Fadajev Kërpaçi, me vendimin nr. 36, datë 4.3.2019, ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit z. Edmond Abaz Rrushi, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga z. Endrit Vullnetar Braimllari si dhe me vendimin nr. 86, datë 20.3.2019, ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit z. Ralf Dhimitër Gjoni, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Klajda Theodhoraq Gjoshja.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor

14 (katërmëdhjetë), 17 (shtatëmbëdhjetë), 18 (tetëmbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 168, datë 16.4.2019, vendimin nr. 176, datë 18.4.2019, si dhe me vendimin nr. 243, datë 7.5.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 20 (njëzet), 21 (njëzet e një) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 343, datë 15.5.2019, ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit z. Edmond Bajram Stojku, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Kejdi Fatmir Mehmetaj.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatin vijues të listës shumemërore me numër rendor 22 (njëzet e dy) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, fjalë e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për deputet me numër rendor 22 (njëzet e dy), z. Ramazan Asim Gjuzi.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.



Me shkresën nr. 3710 prot., datë 16.5.2019, z. Ramazan Asim Gjuzi, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Ramazan Asim Gjuzi, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 23.5.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 6048.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Ramazan Asim Gjuzi, rezulton se: Nuk ka deklaruar dënime penale, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 4930 prot., datë 28.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 4929 prot., datë 28.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Ramazan Asim Gjuzi, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. v-1790/1 prot., datë 29.5.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Ramazan Asim Gjuzi, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ramazan Asim Gjuzi, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidate vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar në listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 22 (njëzet e dy), z. Ramazan Asim Gjuzi.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, pika 2, nenin 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Tiranë, z. Ramazan Asim Gjuzi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

VENDIM Nr. 73, datë 10.5.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË TË GJITHA OST-ve TË EVROPËS KONTINENTALE PËR KARAKTERISTIKAT SHITESË TË FRC-së NË PËRPUTHJE ME NENIN 154 (2) TË RREGULLORES SË KOMISIONIT TË BE-së 2017/1485, TË DATËS 2 GUSHT 2017, QË PËRCAKTON NJË UDHËZUES PËR OPERIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 7, nenit 19, si dhe nenit 67, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 154 (2) të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht



2017, që përcakton një “Udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”; në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 167, të Kodit të Transmetimit, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017; nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe duke konsideruar se, Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a., është anëtar me të drejta të plota i ENTSO-E, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 10.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, për fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të FRC-së, në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 2060 prot., datë 15.3.2019, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimin e të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të FRC-së në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.

- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 19, si dhe nenit 67, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht neni 167 “Sigurimi i FCR-së”.

- “Rezervat e mbajtjes së frekuencës” ose “FCR” nënkupton rezervat e fuqisë aktive të disponueshme për të mbajtur frekuencën e sistemit pas shfaqjes së një çekuilibrimi.

- Ky dokument është një propozim i përbashkët i krijuar nga të gjithë operatorët e sistemeve të transmetimit në lidhje me zhvillimin e karakteristikave shtesë të rezervave për mbajtjen e frekuencës, neni 154 i Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht 2017.

Ky dokument vjen si propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë operatorët e sistemit të transmetimit të zonës sinkron të Evropës Kontinentale në lidhje me zhvillimin e karakteristikave shtesë të rezervave për mbajtjen e frekuencës, neni 154 (2) i Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të FCR-së, në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 78, datë 30.5.2019

PËR KALENDARIN E SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE NË GJYKATËN E APELIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “e”, të pikës 1, të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në shkronjën “e”, pika 4, të nenit 94, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bazuar në pikën 4, të nenit 460, të Kodit të Procedurës Civile, lidhur me përcaktimin e rregullave të hollësishme për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit,

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Caktimi i datës dhe orës së gjykimit të çështjes së ardhur mbi ankim të palës/palëve, bëhet nga gjyqtari relator, në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve, duke



marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit.

2. Caktimi i datës dhe orës së shqyrtimit të çështjes së regjistruar në gjykatën e apelit, kur kjo e fundit vepron si gjykatë e shkallës së parë, bëhet nga gjyqtari relator në respektim të rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, duke mbajtur parasysh objektin e çështjes dhe kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve.

3. Për një çështje, për të cilën Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë ka përcaktuar afat për gjykimin e saj, në caktimin e datës dhe orës së shqyrtimit, gjyqtari relator mban parasysh edhe afatin e posaçëm ligjor të gjykimit të çështjes.

4. Për një çështje, për të cilën Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë nuk ka përcaktuar afat për gjykimin e saj, në caktimin e datës dhe orës së shqyrtimit, në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve (kalendarin me datat e planifikuara të gjykimeve), gjyqtari relator mban parasysh afatin e arsyeshëm sipas nenit 399/2, të Kodit të Procedurës Civile dhe/ose sipas këtij neni në lidhje me nenin 109, pika 4, të ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017.

5. Për një çështje, shqyrtimi i të cilës i është ngarkuar si relator një gjyqtari nga një gjykatë apeli tjetër, gjyqtari relator mban parasysh dhe ngarkesën, si edhe kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën nga e cila vjen.

6. Për një çështje, shqyrtimi i të cilës i është ngarkuar edhe një gjyqtari nga një gjykatë apeli tjetër, gjyqtari relator mban parasysh dhe ngarkesën, si edhe kalendarin e shqyrtimit të çështjeve të këtij gjyqtari.

KREU II

PËRSHPEJTIMI I SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJES MBI KËRKESË TË PALËVE, PËR SHKAK TË NATYRËS DHE KATEGORISË SPECIFIKE TË ÇËSHTJES OSE PËR SHKAQE VEÇANËRISHT TË RËNDA DHE TË MOTIVUARA, KUR KJO NUK VJEN NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN

1. Shqyrtimi i një çështje, për të cilën Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë nuk ka përcaktuar afat për gjykimin e saj, mund të përshpejtohet vetëm mbi kërkesë të palëve, për

shkak të natyrës dhe kategorisë specifike të çështjes ose për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

2. Gjyqtari relator, cakton datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve, duke mbajtur parasysh kërkesat për përshpejtim të paraqitura nga palët. Kriteret që mban parasysh gjyqtari relator për vlerësimin e shkaqeve për përshpejtim të parashtruara nga palët lidhen në veçanti me natyrën dhe kategorinë specifike të çështjes.

3. Çështje me natyrë dhe kategori specifike në kuptim të këtij vendimi janë ato çështje, ku mungesa e shqyrtimit të tyre brenda një afati më të shkurtër se afati i arsyeshëm sipas nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile dhe/ose sipas këtij neni në lidhje me nenin 109, pika 4, të ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017, pas sjell pasoja të rënda për palët në proces dhe për dhënien e drejtësisë.

3.1 Çështje të tilla, sipas natyrës, janë:

- a) çështjet që kanë për objekt të drejta të fëmijës apo që kanë ndikim te një fëmijë i mitur;
- b) çështjet me objekt zgjidhje ose pavlefshmëri martesë;
- c) çështjet me objekt detyrim për ushqim;
- ç) çështjet me objekt kujdestarinë;
- d) çështjet me objekt heqjen, kufizimin ose kthimin e zotësisë për të vepruar dhe ato që kanë për objekt të drejta të personave që iu është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar;
- dh) çështjet me objekt birësimin;

e) çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë është shprehur me vendim jopërfundimtar, ndaj të cilit është ushtruar e drejta e ankimit të veçantë, të tilla si: çështjet me objekt ndreqje gabimi, sqarim ose interpretim të vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë; çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur mospranimin e ankimit në gjykatën e apelit kundër vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë; çështjet me objekt rivendosjen në afat të ankimit në gjykatën e apelit; çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur kthimin e akteve ose pushimin e gjykimit;

ë) çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur refuzimin e dhënies/lëshimit të urdhrit të ekzekutimit;

f) çështjet me objekt plotësim të vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë;



g) çështjet me objekt vërtetim fakti juridik të vjetërsisë në punë ose njohjen e vërtetësisë apo pavërtetësisë së dokumentit me pasoja juridike sa i përket përfitimit të pensionit;

gj) çështjet me objekt shpërblim dëmi nga zgjidhja e kontratës së punës;

h) çështjet në të cilat pala që ka paraqitur ankim heq dorë nga ankimi ose ato në të cilat paditësi heq dorë nga e drejta e padisë;

i) çështjet me interes apo ndjeshmëri veçanërisht të lartë për opinionin publik apo ato që prekin interesa të komuniteteve të caktuara, në veçanti ato në nevojë.

3.2 Çështje të tilla, sipas kategorisë, janë:

a) çështjet për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin/dërgimin për rigjykim në gjykatën e apelit;

b) çështjet që kanë ardhur për gjykim në gjykatën e apelit pas rigjyimit të tyre në gjykatën e shkallës së parë;

c) çështjet që duhen shqyrtuar për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

4. Përveç sa parashikohet në pikat 3.1 dhe 3.2 të këtij Kreu, për çdo lloj çështje, pavarësisht natyrës dhe kategorisë së saj, palët mund të kërkojnë përshpejtimin e shqyrtimit të saj për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin. Këto shkaqe vlerësohen nga gjyqtari relator sipas bindjes së tij të brendshme, bazuar në rrethanat e parashtruara nga pala.

5. Me “shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara” nënkuptohen ato shkaqe personale të palës të lidhura me shqyrtimin e çështjes dhe objektin e saj apo ato shkaqe që përcaktojnë ose kushtëzojnë ecurinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes kryesore të palëve ndërgjyqëse, shkaqe këto, ekzistenca e të cilave, motivon shqyrtimin e përshpejtuar të çështjes, domethënë shqyrtimin e saj në një afat më të shkurtër nga afati ligjor apo nga afati i arsyeshëm sipas nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile dhe/ose sipas këtij neni në lidhje me nenin 109, pika 4, të Ligjit nr.38/2017, datë 30.3.2017.

6. “Shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara” mund të jenë, pa u kufizuar, si vijon:

a) pamundësia objektive e palës për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në një të ardhme të caktuar, ndërsa ajo ka zgjedhur që mbrojtjen e interesave të saj në gjykim ta realizojë

personalisht apo kur prania e saj në gjykim konsiderohet e qenësishme për efekt të procesit të të provuarit;

b) gjendja shëndetësore e palës apo mosha e saj, është e tillë që mund të vërë në dyshim pritshmërinë e saj për një vendim gjyqësor që lidhet me një të drejtë personale;

c) çështja ka përbërë shkak pezullimi për një çështje tjetër gjyqësore;

ç) çështjet, shqyrtimi i të cilave në gjykatën e shkallës së parë ka zgjatur përmbi 2 vjet;

d) çështjet të cilat ligji i ka përcaktuar në juridiksionin fillestar gjyqësor të gjykatës së apelit dhe shqyrtimi i të cilave në juridiksionin administrativ ka zgjatur përmbi 2 vjet.

KREU III

KËRKESA PËR PËRSHPEJTIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES, PARAQITJA DHE SHQYRTIMI I SAJ

1. Kërkesa për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes bëhet në formë të shkruar dhe duhet të nënshkruhet, me pasojë refuzimin e shqyrtimit, nga vetë pala apo përfaqësuesi i saj, i zgjedhur me prokurë ose me deklaram përpara gjykatës.

2. Në kërkesën për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes pala tregon shkakun konkret dhe, kur është rasti, e shoqëron atë me provat përkatëse që vërtetojnë shkakun. Pala apo përfaqësuesi i saj, në kërkesë shënon edhe të dhënat elektronike të kontaktit apo numrin e telefonit me qëllim mundësimin e njoftimit të tij për fatin e kërkesës.

3. Kërkesa për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes depozitohet në zyrën e sekretarisë gjyqësore të gjykatës së apelit ku është regjistruar çështja, nga vetë pala apo përfaqësuesi i saj, duke u identifikuar nëpërmjet një dokumenti të vlefshëm identifikimi, fotokopja e të cilit i bashkëngjitet kërkesës. Në momentin e paraqitjes së kërkesës, nëpunësi civil gjyqësor përgjegjës i sekretarisë gjyqësore verifikon të dhënat e personit që paraqet atë, si dhe shënimin në kërkesë të të dhënave elektronike të kontaktit apo numrit të telefonit dhe, kur është rasti, i kërkon paraqitësit të kërkesës plotësimin aty për aty të këtyre të dhënave.

4. Nëpunësi civil gjyqësor përgjegjës i sekretarisë gjyqësore, jo më vonë se dita e nesërme e punës, kërkesën ia dorëzon sekretarit



gjyqësor të gjyqtarit relator, ndërsa sekretari gjyqësor kujdeset që kërkesa t'i vihet sa më parë në dispozicion gjyqtarit relator.

5. Në rastin kur gjyqtar relator është një gjyqtar i një gjykate tjetër apeli, që është caktuar për shqyrtimin e çështjes me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesa e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes i dërgohet atij në rrugë elektronike, në adresën zyrtare.

6. Sekretari gjyqësor i gjyqtarit relator, jo më vonë se 2 ditë nga dorëzimi atij të kërkesës, pasqyron në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve faktin e paraqitjes së kërkesës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes.

7. Gjyqtari relator shqyrton kërkesën e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, jo më vonë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës.

8. Kur kërkesa e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes vlerësohet e bazuar, gjyqtari relator, vendos pranimin e saj, duke parashtruar dhe arsyet në lidhje me vlerësimin e tij. Në këtë rast, në varësi të ngarkesës dhe të urgjencës së çështjes, edhe intervalin kohor brenda të cilit çështja do të planifikohet në kalendarin e shqyrtimit të çështjeve. Sekretari gjyqësor i gjyqtarit relator kujdeset për ndjekjen e planifikimit të çështjes në kalendarin e shqyrtimit të çështjeve sipas planifikimit paraprak në aktin përkatës të gjyqtarit relator.

9. Kur kërkesa e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes vlerësohet e pabazuar, gjyqtari relator, përmes një shënimi me shkrim dore në trupin e kërkesës, vendos refuzimin e saj. Gjyqtari relator shënon edhe datën kur e shqyrtoi kërkesën, duke nënshkruar poshtë shënimit të tij.

10. Në rastin e gjyqtarit relator nga një gjykatë tjetër apeli, i caktuar për shqyrtimin e çështjes me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, akti i tij për pranimin e kërkesës së palës për përshpejtimin e shqyrtimit ose urdhërimi i tij për refuzimin e kësaj kërkesë, i përcillet sekretarisë gjyqësore së gjykatës ku është çështja, në rrugë elektronike.

11. Kërkesa e refuzuar që paraqitet sërish mbi të njëjtat arsye, si rregull refuzohet.

12. Sekretari gjyqësor i gjyqtarit relator, mbasi merr nga ky i fundit aktin e urdhërimit të tij për kërkesën, kujdeset për plotësimin në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve të të dhënave në lidhje me urdhërimin përkatës të

gjyqtarit relator, si edhe për njoftimin, palës që ka paraqitur kërkesën për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, të këtij urdhërimi. Njoftimi i palës bëhet në të dhënat e kontaktit të paraqitura prej saj, duke pasur ajo të drejtë të tërheqë, pranë sekretarisë gjyqësore të gjykatës së apelit, fotokopjen e dokumentit ose kopjen në letër të komunikimit elektronik me gjyqtarin relator, ku pasqyrohet urdhërimi i gjyqtarit relator mbi kërkesën për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes.

13. Kërkesa e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes me shënimin e gjyqtarit relator dhe, kur është rasti, akti i veçantë i nxjerr nga ai ose kopja në letër të komunikimit elektronik në rastin e gjyqtarit relator nga një gjykatë tjetër apeli, i caktuar për shqyrtimin e çështjes me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, administrohen në dosjen gjyqësore përkatëse.

14. Në çështjen, për të cilën është vendosur përshpejtimi i shqyrtimit të saj, gjyqtari relator iu bën me dije palëve, në fillim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, faktin se ajo është planifikuar me përshpejtim, duke urdhëruar sekretarinë gjyqësore që t'u vërë në dispozicion palëve të pranishme fotokopjen e kërkesës për përshpejtim dhe aktin përkatës të nxjerr nga ai. Njoftimi i palëve për ditën dhe orën e shqyrtimit të çështjes bëhet sipas kërkesave të nenit 460, pikat 5 e 6, të Kodit të Procedurës Civile. Krahas këtij njoftimi, gjyqtari relator urdhëron edhe njoftimin e drejtpërdrejt të palëve, përfaqësuesve të tyre ose prokurorit, sipas rregullave të pjesës I, titulli VI, kreu IV, "Njoftime", të Kodit të Procedurës Civile.

KREU IV DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Kërkesat e paraqitura nga palët për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjeve, të pashqyrtuara ende deri në datën e fillimit të efekteve të këtij vendimi, do t'i nënshtrohen rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Deri në momentin e mundësimit nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve të një raporti tërësor të të dhënave në lidhje me kërkesat e palëve për përshpejtimin e shqyrtimit



të çështjeve, hedhja e të dhënave bazë bëhet në një regjistër të veçantë vjetor në letër, në të cilin, në rend kronologjik, në çdo rresht dhe sipas rubrikave të veçanta, përshkruhen këto të dhëna: numri rendor; kërkuesi (emër dhe mbiemër); çështja (numri dhe data e regjistrimit); data e depozitimit të kërkesës; gjyqtari relator i çështjes (emër dhe mbiemër).

3. Kryetarët dhe kancelarët e gjykatave të apelit marrin masa për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të veçantë të kërkesave për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjeve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet 30 ditë pas hyrjes në fuqi.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

URDHËR
Nr. 314, datë 28.5.2019

**PËR AUTORIZIMIN E NËNSHKRIMIT
TË KËRKESAVE SOCIAL-JURIDIKE TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME
TË ARKIVAVE**

Në mbështetje të nenit 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 134, datë 26.11.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit” dhe Kodit të Procedurave Administrative,

URDHËROJ:

1. Zëvendësimin e z. Armando Boçe, i ngarkuar me detyrë, drejtor i Drejtorisë së Evidencës Qendrore dhe Komunikimit me znj. Elsa Saka, me detyrë përgjegjës i Sektorit të Promovimit dhe Komunikimit, në Drejtorinë e Evidencës Qendrore dhe Komunikimit, e cila autorizohet të nënshkruajë kërkesat social-juridike të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

2. Specimeni i firmës së znj. Elsa Saka të dërgohet në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

3. Urdhri nr. 525, datë 30.10.2018 “Për autorizimin e nënshkrimit të kërkesave social-juridike të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë